



ROACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE 2019-2022

Bashkia Roskovec



Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor

PLANI I VEPRIMIT PËR PËRFSHIRJEN SOCIALE 2019-2022

BASHKIA ROSKOVEC

Programi ROMACTED

Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivel vendor

Një program i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës

Koordinatorë vendore:

Everina Tafa, Bashkia Roskovec

Ekspertë:

Elona Dhembo
Raimonda Duka
Sead Kazanxhiu
Xhesika Korra

Redaktor:

Orsiola Kurti

Ky dokument është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës.

Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të konsiderohen në asnjë mënyrë se pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës.

Të gjitha palët që janë të interesuara për ta riprodhuar apo përkthyer të plotë apo pjesërisht këtë dokument, inkurajohen ta bëjnë diçka të tillë me autorizimin paraprak të Programit ROMACTED (romacted@coe.int).

Dizajni dhe printimi: Gent Grafik

Publikuar prej Programit ROMACTED
Zyra e Këshillit të Evropës në Tiranë
Sheshi Skënderbej, Pallati i Kulturës
Kati i tretë, Tiranë, Shqipëri
www.coe-romacted.org

www.coe.al
www.ec.europa.eu

© Programi ROMACTED, Dhjetor 2020



Falënderime

Jam krenare që Bashkia e Roskovecit ka hartuar dhe miratuar Planin e Veprimit për Përfshirjen Sociale.

Për herë të parë Bashkia e Roskovecit ka një Plan Veprimi për Përfshirjen Sociale me masa konkrete dhe të kostuara mirë, që do të ndërmerren nga aktorët vendorë dhe rajonalë, duke synuar thyerjen e kufizimeve, që pengojnë integrimin dhe përfshirjen sociale të grupeve në nevojë.

Plani i Veprimit për Përfshirjen Sociale në Bashkinë e Roskovecit vjen si rezultat i një procesi të gjatë dhe gjithëpërfshirës, takimesh e konsultimesh të gjera, përpjekjesh dhe bashkërendimi të punëve me të gjithë aktorët, që veprojnë në sektorë të ndryshëm dhe reflekton nevojat reale dhe urgjente të komunitetit.

Ky plan synon të ndikojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në Bashkinë Roskovec, bashkëpunimin e saj me qeverisjen qendrore dhe organizatat jo qeveritare, duke sjellë rezultate të prekshme për jetën e qytetarëve nëpërmjet treguesve të matshëm.

Një falënderim i veçantë për Programin ROMACTED të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për ndihmesën e tyre në finalizimin e këtij dokumenti të rëndësishëm. Falë mbështetjes së këtij programi ne kemi sot një hartë me hapa dhe masa konkrete për të adresuar njëherë e mirë një plagë sociale të mbartur prej dekadash.

Ne sigurojmë dhe vlerësojmë mbështetjen e partnerëve tanë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, për të bërë të mundur jetëzimin e angazhimeve dhe masave të Planit të Veprimit të Përfshirjes Sociale 2019-2022, duke e bërë Roskovecin në qytet më të mirë për qytetarët.

Majlinda BUFI

Kryetare e Bashkisë Roskovec

Pasqyra e Lëndës

FALËNDERIME	5
I. HYRJE	9
II. METODOLOGJIA DHE PROCESI	12
III. TREGUESIT SOCIALË	16
III.1 TREGUESIT DEMOGRAFIKË	16
III.2. ARSIMI	17
III.3 SHËNDETËSIA	20
III.4 SITUATA E PAK	22
III.5 VARFËRIA DHE NDIHMA EKONOMIKE	23
IV. HARTËZIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE DHE NEVOJAVE	
SIPAS GRUPEVE SOCIALE	26
IV.1 SHËRBIMET REZIDENCIALE TË KUJDESIT SHOQËROR	26
IV.2 SHËRBIME DITORE DHE KOMUNITARE DHE NEVOJAT	
SIPAS GRUPEVE SOCIALE	26
IV.3 PARTNERITETI ME OJF-TË DHE AKTORË TË TJERË	32
V. MISIONI, VIZIONI DHE OBJEKTIVAT	34
VI. PLANI I VEPRIMIT	37
VII. STRATEGJIA E ZBATIMIT	64
VIII. BURIMET FINANCIARE	67
IX. SHTOJCA	71
IX.1 METODA DHE TEKNIKA PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE PARËSORE, ME PJESËMARRJEN E KOMUNITETIT	71
IX.2 LISTA E DOKUMENTEVE TË KONSULTUARA	74
IX.3 GRUPI INSTITUCIONAL I PUNËS, BASHKIA ROSKOVEC	76
IX.4 VENDIMI I KËSHILLIT BASHKIAK ROSKOVEC	77

Lista e shkurtesave

AK	Aftësi e Kufizuar
DBNJ	Drejtoria e Burimeve Njerëzore
DF	Drejtoria e Financave
FLAG	Fondacioni për Qeverisje dhe Autonomi Vendore
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
IRCA	Instituti i Kulturës Rome në Shqipëri
MFE	Ministria e Financve dhe Ekonomisë
MSHMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NE	Ndihmë Ekonomike
NjA	Njësi Administrative
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjVNR	Njësia e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit
PAK	Person me Aftësi të Kufizuara
PIM	Plani i Masave
PMF	Punonjësi për Mbrojtjen e Fëmijëve
QSH	Qendër Shëndetësore
QSK	Qendra Sociale Komunitare
R&E	Romë dhe Egjiptianë
SÇBGJDHF	Spektori i Çështjeve të Barazisë Gjinore dhe Dhunë në Familje
SSHS	Spektori i Shërbimeve Sociale
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
USAID	Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillimin Ndërkombëtar

Hyrje

Në vijim të reformës territoriale të Republikës së Shqipërisë në vitin 2015, Bashkia Roskovec, pjesë e Qarkut Fier, ka në përbërje të saj 4 njësi administrative (Figura 1): Roskovec, Kuman, Kurjan dhe Strum (Ligji nr.115/2014). Aktualisht, Bashkia Roskovec administron një qytet – Roskovecin, si dhe 14 fshatra (shiko Tabelën 1). Bashkia Roskovec kufizohet në veri dhe perëndim me Bashkinë Lushnjë, në jug me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Ura Vajgurore, ndërsa në perëndim me Bashkinë Patos. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Roskovecit.

Tabela 1. Njësitë Administrative dhe përbërja e tyre

Bashkia	Njësi Administrative (NjA)	Qytetet dhe Fshatrat për NjA
Roskovec	Roskovec	Qyteti Roskovec, Fshati: Jagodinë
	Kuman	Kucman, Marinëz, Vidhishtë, Luar
	Kurjan	Kurjan, Mbers, Ngjeqan, Vlosh
	Strum	Strum, Arapaj, Suk 1, Suk 2, Velmish

Sipas Censurit të vitit 2011, bashkia e re e Roskovecit duhet të kishte rreth 21.742 banorë, ndërsa në Regjistrin Civil popullsia e regjistruar figuron 31.548 banorë. Kjo bashki ka një sipërfaqe prej 118.01 km² dhe në bazë të popullsisë së numëruar nga Censusi, densiteti i popullsisë është 184 banorë për kilometër katror, përkundrajt asaj në bazë të regjistrit civil ku densiteti rezulton 263.33 banorë/ km².



Figura 1. Harta administrative
Burimi: Bashkia Roskovec

Tabela 2. Shpërndarja e Popullsisë sipas Njësie Administrative, Distanca nga Qendra dhe Sipërfaqja për Njësi

Bashkia Roskovec	Njësia Vendore	Popullsia		Distanca nga qendra (km)	Sip. e njësisë në km ²
		Gjendja në Regjistrin Civil 2018	Census 2011		
	Strum	9345	7538	8.1	35.2
	Kurjan	5,318	3,618	9	37
	Kuman	8,519	5,611	2	32
	Roskovec	8,859	4,975	0	19
	<i>Total</i>	<i>32041</i>	<i>21742</i>		<i>123.2</i>

Në kuadër të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Bashkia Roskovec, ngarkohet, ashtu si edhe njësitë e tjera të qeverisjes vendore, me një gamë të gjerë përgjegjësish dhe kompetencash në fushën e shërbimeve të kujdesit shoqëror, si niveli më i përshtatshëm për ofrimin e shërbimeve shoqërore për përfituesit, për shkak të afërsisë me komunitetin dhe me qytetarin. Shërbimet e kujdesit shoqëror përfshijnë ofrimin e shërbimeve shoqërore komunitare, shqyrtimin dhe vendimmarrjen në lidhje me procedurat për marrjen në kujdestari; si edhe menaxhimin e shërbimeve rezidenciale në raste specifike. Gjithashtu, në legjislacion përcaktohen detyrimet specifike për shërbimin shoqëror në nivel vendor, duke përfshirë ngritjen e pikave fokale gjinore dhe të luftës kundër dhunës në familje, si dhe Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës.

Strategjia Ndërsëktoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore (2015 – 2020) cilëson shërbimet e kujdesit shoqëror si funksion i pushtetit vendor, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore. Gjithashtu, strategjia shpreh synimin e qeverisë për decentralizimin e plotë të shërbimeve të kujdesit shoqëror, përkundrejt mbështetjes teknike, institucionale dhe financiare nga burimet e buxhetit të shtetit.

Nga ana tjetër, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 vijëzon një orientim të qartë politikash për kujdesin shoqëror, me qëllim reformimin e sistemit, duke theksuar se ‘fillimisht identifikojnë çështjet kyçe që duhen adresuar për të ndërtuar një sistem funksional, dhe së dyti përdorim të një qasjeje me faza për ta zhvilluar këtë sistem’. Në fazën e parë, fokusi vendoset në ndërtimin e themeleve

për të lejuar pilotimin e sistemit të ri të shërbimeve të kujdesit shoqëror në rajone të caktuara. Hapat e hedhur në raport me përcaktimin e roleve dhe përgjegjësi të qarta për bashkitë e formuara rrishtazi për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror (të pasqyruara në ligjin e ri për vetëqeverisjen vendore, strategjinë e decentralizimit dhe atë të mbrojtjes sociale), përparimi i konceptit të paketës bazë të shërbimeve (apo shportës), miratimi i Ligjit 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror”, miratimi i Ligjit 18/207 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, po përforcojnë bazën ligjore në mënyrë që sistemi të funksionojë duke qartësuar më shumë funksionimin e sistemit të ri të kujdesit shoqëror ku ministria përgjegjëse, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, zhvillon politikat dhe përcakton prioritetet, ndërkohë që bashkitë janë përgjegjëset kryesore për planifikimin dhe buxhetimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Në këtë kuadër, Bashkia Roskovec merr përsipër hartimin e Planit të Përfshirjes Sociale, i cili pasqyrohet në këtë dokument. Në këtë proces, ajo është mbështetur prej programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës “ROMACTED: Promovimi i qeverisjes së mirë dhe fuqizimit Rom në nivelin vendor” dhe prej Institutit të Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA) si organizatë mbështetëse përgjatë vlerësimit të nevojave lidhur me hartimin e planit, buxhetimin e tij dhe identifikimin e burimeve financiare për ta zbatuar atë, duke rritur kapacitetet vendore në këtë drejtim.

II. Metodologjia dhe procesi

Metodologjia dhe procesi i përshkruar për hartimin e Planit Social është mbështetur në udhëzuesin për hartimin e planeve për integrimin e pakicave rome dhe egjiptiane përgatitur me mbështetjen e Programit ROMACTED si dhe udhëzuesin e përgatitur nga ISB dhe ESA Consulting për hartimin e planeve sociale¹. Në themel të metodologjisë së zbatuar dhe procesit të ndjekur hap pas hapi është një frymë e përgjithshme gjithëpërfshirjeje. Kjo është mundur duke siguruar që çdo përpjekje e ndërmarrë në këtë kuadër të udhëhiqet nga parimet e fuqizimit, pjesëmarrjes dhe integritit të grupeve sociale më të cenuara në shoqëri. Në punën me pakica në nevojë besohet se fuqizimi apo mundësia për fuqizim e çdo individ është thelbësore për fuqizimin dhe integrimin e të gjithë komunitetit/grupit/pakicës.

Në këtë prizëm, adresimi i nevojave dhe problematikave përmes një modeli integruar, ku jetët e njerëzve dhe nevojat e tyre shihen, vlerësohen dhe mbështeten nga një këndvështrim multidisiplinar dhe shumëplanësh, kanë qenë në themel të përjasjes sonë. Ndryshimet, përmirësimet dhe arritjet mund të jenë të qëndrueshme veçse përmes një strategjie të tillë, ku përjasja e integruar nënkupton nevojën për koordinim dhe sinergji në fusha si arsimi, punësimi, përkujdesi shëndetësor, strehimi dhe shërbimet shoqërore.

Për arritje të qëndrueshme, gjatë të gjitha përpjekjeve të ndërmarra u inkurajuan dhe zbatuan procese me pjesëmarrje. Pjesëmarrja e komuniteteve në të gjitha proceset i bën ato jo vetëm më të hapura, transparente dhe ndërvepruese, por shton shanset e suksesit si dhe i bën proceset dhe rezultatet, që vijnë prej tyre më të pranueshme e të zbatueshme nga komunitetet e synuara. Pjesëmarrja e përfaqësuesve nga këto grupe në çdo hap të konceptimit të këtij plani siguroi, ndër të tjera, që edhe të dhënat dhe evidencat e mbledhura për të ushqyer hartimin e tij të ishin të përditësuara dhe të përshtatshme. Ato e përforcuan më tej ndjesinë e pronësisë dhe përgjegjshmërisë për planin dhe zbatimin e tij.

Më konkretisht, procesi për hartimin e planit social në nivel vendor për Bashkinë Roskovec kaloi përmes katër hapave kyç, të përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

1 ISB dhe ESA Consulting (2016) *Udhëzues: Instrumentet për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror*, ESA/UNICEF, Albania.

Tabela 3. Hapat e procesit për hartimin e Planit të Veprimit për Përfshirjen Sociale, Bashkia Roskovec

Hapi 1. Përgatitja e procesit dhe angazhimi	Hapi 2: Vlerësimi i nevojave dhe prioritizimi i tyre
<p>Detyrat e realizuara ishin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Identifikimi i aktorëve – përgjatë të cilit iu dha përgjigje pyetjeve “Kush do të përfshihet?” “Pse? Ç’kontribute sjell?” b) Garantimi i angazhimit politik – mundësoi identifikimin e aktorëve të vullnetshëm dhe çoi më tej dejt angazhimit të tyre politik për realizimin e procesit. c) Ngritja dhe mbështetja teknike për grupet dhe nën-grupet e punës për hartimin e planit. 	<p>Vlerësimi i nevojave të komunitetit kaloi përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Mbledhjes së të dhënave – këtu u përcaktuan burimet e të dhënave, teknikat për mbledhjen e tyre, si dhe indikatorëve/treguesve përkatës. b) Identifikimi dhe prioritizimi i problemeve dhe nevojave – me pjesëmarrjen e komuniteteve u identifikuan problematikat dhe nevojat e tyre si dhe u caktua se çfarë është më prioritar dhe e menjëhershme për adresim në kushtet e burimeve dhe kohës së kufizuar. c) Vlerësimi i kapaciteteve institucionale – ku iu dha përgjigje pyetjeve “Kush mund të bëjë çfarë për adresimin e problematikave/nevojave të identifikuar?”.
Hapi 3: Hartimi dhe miratimi i një Plani Veprimi të Përbashkët	Hapi 4: Financimi dhe zbatimi i projektit
<p>Hapi i tretë mundësoi hartimin dhe miratimin e planit të përbashkët të veprimit dhe përfshiu reflektim dhe adresim të të mëposhtmeve:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Reflektim – Çfarë dimë nga procesi i vlerësimit të nevojave dhe prioritizimit të tyre? b) Ku synojmë të arrijmë? Ç’ndryshime duam të sjellim? c) Si? – aktivitetet afatshkurtra & afatmesme. d) Integrimi i çështjeve rrome në planin vendor – Si? Integrimi si pjesë e së tërës. Planet Sociale. e) Aktivitete/ndërrhyrje/ projekte konkrete – Çfarë? Kush? Kur? 	<p>Hapi i katërt ndërtoi rrugën drejt një plani të zbatueshëm, duke përfshirë çështje si financimi dhe monitorimi i tij. Gjatë këtij hapi iu dha përgjigje pyetjeve të mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Sa % e financimit të Planit Vendor do të mbulohet nga buxheti NJVQVsë? A parashikohen financime nga buxheti i shtetit? Donatorët? b) A ka hendek financiar? Cilat janë burimet e mundshme për financimin e projekteve të reja? c) Sa % e shpenzimeve të Planit Vendor janë të planifikuara në PBA-në 2019-2021? d) A kemi aktivitete/projekte të reja? Sa % të shpenzimeve zënë ato? Si planifikohet financimi i tyre? e) A është hendeku financiar pjesë e kërkesave buxhetore shtesë dhe bisedimeve me donatorë të ndryshëm?

Me qëllim vlerësimin e nevojave dhe informimin e proceseve politikëbërëse/ vendimmarrëse lidhur me planin përmes të dhënave dhe evidencave u hartua dhe u zbatua një udhëzues për mbledhjen e të dhënave parësore dhe dytësore. Ato përfshinë burime të ndryshme, të përmbledhura në skemën ilustruese më poshtë.




Figura 2. Burime parësore dhe dytësore të të dhënave të përdorura

Për mbledhjen e të dhënave parësore përmes teknikave me pjesëmarrjen e komunitetit, u përdorën ushtrimet e hartëzimit të nevojave dhe burimeve, intervista individuale dhe diskutime në grupe. Të gjitha këto u shoqëruan me një seri vizitash, vëzhgimesh dhe takimesh në terren në zonat e Bashkisë Roskovec dhe me grupet me problematika socio-ekonomike më të mprehta. Kështu, në periudhën shkurt-prill 2019, ekspertja kombëtare dhe lehtësuesit vendorë të programit ROMACTED kanë vizituar në vazhdimësi këto zona dhe kanë përdorur një seri mjetesh dhe teknikash për mbledhjen e të dhënave.



Figura 2. Pamje nga aktivitetet për mbledhjen e të dhënave

Për një diskutim më të fokusuar dhe thelluar, si dhe për njohjen më të thellë dhe tërësore të problemeve dhe nevojave janë zbatuar edhe metodat e diskutimit në fokus-grupe, është zbatuar “Hartëzimi i Burimeve”, “Pema e problemit” dhe “Matrica e Problemeve”, “Prioritizimi i Problemeve” (për më shumë shiko Shtojca 8.1). Të dhëna parësore u mbledhën edhe nga Bashkia, veçanërisht në raport me kapacitetet e saj në fuksion të planit social, përgjatë takimeve me Grupin Institucional të Punës të ngritur në kuadër të Programit ROMACTED.



Figura 3. Pamje nga takimet me Grupin Institucional të Punës në Bashkinë Roskovec

Gjetjet që rezultuan nga vlerësimi i nevojave informuan procesin e hartimit të Planit të Veprimit të Përfshirjes Sociale për Bashkinë Roskovec.

III. Treguesit sociale

III.1 Treguesit demografikë

Bashkia Roskovec ka një popullsi të re në moshë, të vendosur në pjesën më të madhe në njësitë administrative Strum dhe Roskovec (Tabela 3). Megjithatë, të dhënat demografike tregojnë për një prirje në rënie të lindjeve dhe një thellim të dallimeve gjinore (veçanërisht në popullsinë më të re në moshë). Jo vetëm në grupmoshën mbi 65 vjeç, por edhe për grupmoshat nga 0-64 vjeç, jetojnë më shumë djem dhe burra sesa vajza dhe gra. Nga ana tjetër, numri i lindjeve ka ardhur në rënie, siç vërehet edhe nga të dhënat e regjistruara për dy vitet e fundit (Figura 4). Po kështu, ndonëse jo shumë i madh, numri i divorceve ka ardhur në rritje dhe kjo ka ndikuar edhe në diversifikimin e tipeve të familjeve dhe nevojave të tyre në këtë bashki (për shembull janë shtuar familjet me një prind, me nëna kryefamiljare etj.).

Tabela 4. Popullsia e Bashkisë Roskovec, sipas gjinisë dhe grupmoshave - 2018

Bashkia Roskovec	Njësia Vendore	Popullsia		Popullsia sipas grupmoshave					
		Gjendja në Regjistrin Civil 2018	Census 2011	0-17 vjeç		17-64 vjeç		65+ vjeç	
				femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj
Strum	9345	7538	845	963	2420	2602	370	338	
Kurjan	5,318	3,618	394	430	1181	1239	193	181	
Kuman	8,519	5,611	601	615	1848	1894	346	307	
Roskovec	8,859	4,975	484	535	1664	1706	323	263	

Burimi: Të dhëna administrative




Figura 4. Lindje, vdekje dhe divorce – Bashkia Roskovec 2017 dhe 2018

Pjesa më e madhe e popullsisë së kësaj bashkie jeton në zona me natyrë rurale, gjë që lidhet ngushtë me natyrën e jetesës dhe aktivitetet socio-ekonomike që zhvillohen. Duke mbajtur në kosideratë se jeta social-kulturore në zonat rurale në përgjithësi, në shkallë vendi, është varfëruar së tepërmi në dekadat e tranzicionit, kjo e bën që edhe sfidat e një bashkie ku pjesa më e madhe e popullsisë të jenë të vendosura në këto zona të jenë edhe më dinamike.

III.2. Arsimi

Kujdesi i hershëm lidhet ngushtësisht me trajektorët që merr arsimimi dhe edukimi i fëmijës. Bashkia Roskovec ka një shtrirje të kufizuar të shërbimeve të përkujdesit për fëmijët. Në të gjithë Bashkinë mungon shërbimi për moshat 0-3 vjeç pasi nuk ka ende asnjë çerdhe që ofron shërbim për këtë kategori fëmijësh. Mungesa e një shërbimi të tillë lidhet jo vetëm me vijimësinë e frekuentimit më pas të kopshtit, por edhe me mundësitë që krijohen (kryesisht) për nënat me fëmijë të kësaj grupmoshe për të kombinuar mëmësinë me punësimin në tregun e punuës.

Ndonëse prezente edhe kopshtet janë të kufizuar në numër dhe shtrirjen e shërbimit.

Tabela 5: Kopshtet, Bashkia Roskovec 2019

Nr.	Njësia Administrative	Popullsia	Numri i kopshteve	Kapaciteti	Numri i fëmijëve	Numri i fëmijëve romë	Numri i edukatoreve	Raporti nr.fëmijësh /edukatore	Numri i kopshteve për 10.000 banorë	Numri i edukatoreve për 10.000 banorë
1	Roskovec	8,919	2		180	8	11	16.0	1	0
2	Kuman	8,603	4		170	0	10	17.0	1	0
3	Strum	9,345	4		133	0	6	22.0	1	0
4	Kurjan	5,409	4		75	0	4	19.0	1	0
	Total	32,276	14		558	8	31			

Burimi: Të dhëna administrative, Bashkia Roskovec

Siç tregohet edhe nga të dhënat në Tabelën 5, numri i kopshteve në këtë bashki është relativisht i ulët. Kjo është më e dukshme në NjA Roskovec ku raportohet të ketë vetëm 2 kopshte funksionale (nga të cilët vetëm njëri me orar të plotë). Vetëm në kopshtet e NjA Roskovec ka pjesëmarrje të fëmijëve nga pakicat rome. Përveç problematikave të tjera që pengojnë pjesëmarrjen dhe hyrjen e hershme të fëmijëve në sistemin para-shkollor, një pjesë e frekuentimit të kufizuar shpjegohet nga vështirësitë për të aksesuar këto shërbime ku ndër më specifiket e listuara nga përfaqësues të pakicave rome u listua infrastruktura e dobët (mungesa e një rruge me standarde që lidh vendbanimet e tyre me kopshtet/shkollat) apo mungesa e transportit. Papunësia relativisht e lartë tek gratë gjithashtu bën që një pjesë e fëmijëve të mbahen në shtëpi.

Për sa u takon shkollave, ato 9-vjeçare janë të pranishme pothuajse në të gjitha NjA-të e bashkisë dhe kapaciteti i tyre e tejkalon numrin e fëmijëve që i frekuentojnë ato. Megjithatë, raportohen problematika lidhur me raste të braktisjes së shkollës (ndonëse në nivele të ulëta, ato janë prezente), shtrirjen e kufizuar të shërbimit psiko-social, si dhe problematika lidhur me infrastrukturën fizike dhe atë të burimeve njerëzore në disa prej shkollave. Tabela 6 jep më shumë detaje mbi secilën prej shkollave.

Tabela 6. Shkollat 9-vjeçare, 2018-2019, Bashkia Roskovec

	NJA	Nr. Shkollae	Kapaciteti	Nr.nxënësve	Nr. Nxënësve rom	Niveli i braktisjes së shkollës (nr. nxënësish)	Nr. i mësuesve	Nr. fëmijëve/ mësues	Nr.shkollave/ 10.000 banorë	Nr.mësueve/ 10.000 banorë	Nr. psikologëve (punësuar pranë shkollave të NJA)
1	Roskovec	1	630	557	18	1	38	15	1	-	1
2	Vidhisht	1	300	157	0	0	13	12	1	-	1
3	Luar	1	200	150	0	1	15	10	1	-	1
4	Kurjan	1	350	265	0	0	20	14	1	-	1
5	Ngjeqar	1	300	74	0	0	10	8	1	-	1
6	Strum	1	450	204	0	0	13	15	1	-	1
7	Suk1	1	300	295	0	1	26	11	1	-	1
9	Velmish	1	250	131	0	0	13	10	1	-	1
10	Kuman	1	300	130	5	0	14	10	1	-	1
11	Marinëz	1	300	113	0	0	14	9	1	-	1
12	Vlosh	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Të dhëna administrative /Drejtoria Rajonale për Arsimin, Roskovec

Bashkia Roskovec ka vetëm dy shkolla të mesme të përgjithshme². Aksesi ndaj tyre është i vështirë për fëmijët e zonave rurale dhe pjesëmarrja e fëmijëve romë është e papërfillshme. Në këtë bashki mungojnë alternativat e arsimit të mesëm profesional. Të interesuarit për të marrë një profesion të certifikuar përmes arsimit të mesëm profesional iu duhet t'i dejtohen mundësive në bashkitë e tjera. Kjo shihet si një sfidë me një ndikim të drejtpërdrejtë edhe në mundësitë për punësim të të rinjve në përgjithësi dhe atyre nga komuniteti rom apo familjeve në nevojë në veçanti.

2 Burimi, faqja zyrtare e Bashkisë Roskovec, <http://bashkiaroskovec.gov.al/shkollat-dhe-kopshtet/>

III.3 Shëndetësia

Bashkia Roskovec i adreson nevojat e qytetarëve të saj përmes qendrave shëndetësore dhe ambulancave. Shërbimi spitalor mungon në këtë bashki. Për të qytetarët duhet të drejtohen në bashki të tjera, në mënyrë tipike në bashkinë Fier e cila është edhe më pranë.

Siç tregohet edhe nga të dhënat e Tabelës 7, numri i mjekëve të familjes për të gjithë bashkinë është 9 dhe ai i infermierëve 37. Mjekët specialistë mungojnë totalisht. Kjo krijon vështirësi për qytetarët në përgjithësi dhe ata nga grupe në nevojë për të marrë shërbimet e nevojshme shëndetësore, të specializuara sipas nevojave që kanë.

Tabela 7. Shërbimet shëndetësore, Bashkia Roskovec 2018

Të dhëna administrative, Bashkia Roskovec 2018		Spitale		Personeli mjekësor QSh & Ambulanca		Numri i Qendrave Shëndetësore dhe Ambulancave	Popullsia		Total (staf mjekësor) për 1000 banorë
Bashkia	Njësi Administrative	Spitale	Nr. shtretëri	Mjekë familje	Mjekë Specialistë		Gjendja/ RC me 2018	Census 2011*	
Strum		0	0	2	0	1 Q,Sh + 5 Ambulanca	9345	7538	1
Kurjan		0	0	2	0	1 Q,Sh + 3 Ambulanca	5,318	3,618	1.69 (2)
Kuman		0	0	2	0	1 Q,Sh + 3 Ambulanca	8,519	5,611	1.17
Roskovec		0	0	3	0	1 Q, Sh + 2 Ambulanca	8,859	4,975	1.91 (2)
Total		0	0	9	0		32041	21742	37
ROSKOVEC									

Burimi: Burimet administrative, Ministria e Shëndetësisë/Drejtori Rajonale

III.4 Situata e PAK

Bashkia Roskovec vazhdimisht mbledh dhe përditëson të dhënat lidhur me personat me aftësi të kufizuar në territorin e saj. Për vitin 2018 raportohet për një total prej 563 personash me aftësi të kufizuar, të cilët janë përfytyes së pagesës së aftësisë të kufizuar. Megjithatë, më pak se gjysma e tyre janë përfytyes të kujdestarisë. Shpërndarja e tyre sipas njësive administrative paraqitet në Tabelën 8.

Tabela 8. PAK në Bashkinë Roskovec, 2018

	GJITHSEJ		TË VERBËR		PARA-TETRAPLEGJIKË		PAK MENDOR E FIZIK	
EMËRTIMI	Gjithsej	Me përfytyim kujdestarie	Gjithsej	Me përfytyim kujdestarie	Gjithsej	Me përfytyim kujdestarie	Gjithsej	Me përfytyim kujdestarie
Njësia Roskovec	87	32	14	4	11	11	62	7
Njësia Strum	189	80	27	10	29	29	133	24
Njësia Kuman	161	79	46	8	17	17	98	16
Njësia Kurjan	126	56	22	8	15	15	89	19
Bashkia Total	563	247	109	30	72	72	382	66
Numri i fëmijëve (0-18 vjeç) me AK që përfytojnë pagesë e PAK	124	39	5	2	9	9	110	25

Burimi: Të dhëna administrative, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social

Siç tregohet në Tabelën 8 një total prej 124 personash, apo rreth një në 5 persona me aftësi të kufizuar, është nën moshën 18 vjeç. Fëmijët me aftësi të kufizuar jetojnë në secilën prej njësive administrative të kësaj bashkie, por numri më i lartë është në NjA Kurjan (shiko Tabelën 9). Pjesa më e madhe e fëmijëve me aftësi të kufizuar janë në moshë shkollimi të detyrueshëm, por integrimi i tyre në shkolla paraqitet shumë sfidues dhe kërkon përpjekje dhe vëmendje të shtuar.

Tabela 9. Shpërndarja e fëmijëve me aftësi të kufizuar në Bashkinë Roskovec, 2018

	Gjithsej	0-6 vjeç	6-15vjeç	15-18 Vjeç
Njësia Roskovec	18	5	9	4
Njësia Strum	32	10	13	9
Njësia Kuman	25	4	15	6
Njësia Kurjan	49	28	18	3
Bashkia Total	124	47	55	22

Burimi: Të dhëna administrative, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social

III.5 Varfëria dhe ndihma ekonomike

Papunësia, mungesa e të ardhurave nga punësimi, vetëpunësimi apo e mundësive për gjenerimin e tyre, bëjnë që problematikat e varfërisë të jenë mjaft të ndjeshme në Bashkinë Roskovec. Një tregues i kësaj problematike është edhe skema e Ndhmës Ekonomike (NE). Për vitin 2018, rreth 187 familje ishin përfituese të NE, me një masë mesatare prej 4880 lek/muaj. Përqendrimi më i lartë në njësinë administrative Kurjan (me mbi 50%) tregon edhe për dallimet në zhvillim dhe mundësi edhe midis njësive administrative.

Tabela 10. Programi i ndihmës ekonomike, Bashkia Roskovec 2018

	Bashkia Roskovec	Njësia Roskovec	Njësia Kurjan	Njësia Kuman	Njësia Strum	Total
Përfitues të NE	Familje përfituese gjithsej: viti 2018	25	108	17	37	187
	Ndër të cilat: familje në fshat (rurale)	0	108	17	37	162
	Masa mesatare e përfitimit në LEK (2018)	4900	5170	4000	5440	4880
	Ndër të cilat: përfituese të NE përmes fondit të bashkisë (6%)	4	1	1	1	7
Karakteristikat e familjeve përfituese të NE: viti 2018	Familje me grua kryefamiljare	1	34	4	7	46
	Familje me deri në 2 fëmijë të mitur	6	46	3	7	62
	Familje me mbi 2 fëmijë të mitur	3	37	1	21	62
	Familje rome	0	0	0	0	0
	Familje me të paktën një anëtar PAK	3	0	0	6	9
	Familje me të paktën një anëtar në moshë pensioni	0	1	1	1	3
	Familje në nevojë	17	99	11	33	160
	Jetimë	2	4	0	3	9
	Prindër shumënjakësh	1	1	0	0	2
	Viktima trafikimi	0	0	0	0	0
Familjet përfituese sipas kategorive: viti 2018	Viktima dhune në familje	3	2	2	0	7
	Familje me fëmijë në kujdestari	2	2	4	1	9
	Ndër të cilat: përfituese të NE përmes fondit të bashkisë (6%)	4	1	1	1	7

Burimi: Të dhëna administrative, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social

Rreth një e katërta e të gjitha familjeve përfituese përbëhet nga familje me gruan kryefamiljare, dëshmi e vëmendjes ndaj kësaj kategorie, por edhe e vështirësive dhe sfidave më të mëdha, që gratë në përgjithësi dhe veçanërisht ato kryefamiljare hasin për të siguruar punësim.

Të dhënat e paraqitura në këtë seksion janë mjaft ndihmuese për sa i takon njohjes me shtrirjen dhe përfitimin e shërbimeve sipas fushave të specifikuar. Megjithatë, mungesa e të dhënave lidhur me vlerësimin/përcaktimin e nevojave, të cilat kanë mbetur pa u mbyllur/adresuar, e bën njohjen e problematikave dhe gjendjes shoqërore të pjesshme dhe nevojën për monitorim, vlerësim dhe dokumentim të vazhdueshëm prioritarë.

IV. Hartëzimi i shërbimeve shoqërore dhe nevojave sipas grupeve sociale

IV.1 Shërbimet rezidenciale të kujdesit shoqëror

Bashkia Roskovec është një bashki e vogël dhe e krijuar rishtazi, ndaj trashëgimia e një rrjeti shërbimesh shoqërore mungon. Deri më tani, Bashkia Roskovec nuk ka mundur ende të krijojë apo mbështesë shërbime të një natyre rezidenciale, për asnjë nga kategoritë apo grupet në nevojë, si të moshuarit, fëmijët, gratë e dhunuara etj. Ndonëse kjo është një mangësi mjaft e ndjeshme dhe ngritja e një qendre rezidenciale do të shërbente në adresimin e problematikave të disa grupeve në nevojë, ajo mbetet një sipërmarrje, që bazuar në burimet dhe mundësitë aktuale të Bashkisë, duket e largët për t'u realizuar.

Pavarësisht një konteksti me një trashëgimi të dobët apo inekzistent të shërbimeve shoqërore si dhe burimesh të kufizuara, Bashkia Roskovec është përpjekur t'u japë vëmendje nevojave sociale përmes zhvillimit dhe mbështetjes së shërbimeve ditore dhe komunitare. Në seksionin e mëposhtëm paraqiten shkurtimisht këto shërbime ekzistuese dhe grupet, që përfitojnë prej tyre kundrejt nevojave të identifikuara.

IV.2 Shërbime ditore dhe komunitare dhe nevojat sipas grupeve sociale

IV.2.1 Të moshuarit

Të moshuarit në Bashkinë Roskovec përballen me problematika të ngjashme me ato të të moshuarve në bashki të tjera të vendit, si vështirësitë ekonomike, problematikat e lidhura me problemet e shëndetit dhe kujdesit shëndetësor jo (gjithmonë) cilësor dhe të aksesueshëm etj. Gjithnjë e më tepër, për moshat e thyera po shtohet problematika e vetmisë si pasojë e emigrimit në vite dhe largimit të brezit me të ri drejt vendeve më të zhvilluara.

Aktualisht, Bashkia u shërben të moshuarve rezidentë në territorin e saj vetëm përmes shërbimeve ditore të Qendrës Sociale Komunitare (QSK). Në mjediset e kësaj qendre të moshuarit socializohen me njëri-tjetrin dhe kalojnë një kohë aktive duke luajtur lojra të ndryshme. Ndonëse nuk ka statistika të sakta, sipas

burimeve nga stafi që shërben në qendër, mendohet se qendra frekuentohet nga rreth 50 të moshuar.

Edhe pse Bashkia ka pasur si synim pasurimin me shërbime të tjera të qendrës për këtë kategori, këto nuk janë realizuar ende. Nga ana tjetër, mungesa e fondeve e bën kërkesën për një qendër rezidenciale një objektiv të largët. Familjet kujdestare mund të ishin një praktikë e re që mund të plotësonte nevojat për përkujdes të vazhdueshëm për të moshuarit me një kosto më të ulët, por praktikat në këtë drejtim mungojnë dhe vlerësohet se ka shumë pak interes për punë vullnetare në këtë drejtim.

IV.2.2 Fëmijët

Bashkia Roskovec ka ngritur së fundmi Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMFnë), si pjesë e Sektorit të Shërbimeve Sociale. Punonjësja për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në zbatim të kuadrit ligjor për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve, veçanërisht të Ligjit 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve në Republikën e Shqipërisë" zbaton procedura në raport me identifikimin dhe menaxhimin e rasteve specifike të fëmijëve në nevojë për t'u marrë në mbrojtje, ashtu edhe përsa i takon roleve të tjera, si ato ndërgjegjësuese, koordinuese etj. Kjo strukturë gjithashtu drejton grupin multidisiplinar për ndjekjen e rasteve. Megjithatë, puna e realizuar prej NjMFsë për vitin 2018 ka qenë mjaft e kufizuar, duke raportuar për vetëm 1 rast të ndjekur përgjatë gjithë vitit. Nga ana tjetër, shërbimi psiko-social në shkolla mbulohet vetëm nga 1 psikologe për të gjithë Bashkinë (me një total prej 14 shkollash). Kombinimi i këtyre kapaciteteve duket që në pamje të parë i pamjaftueshëm për adresimin e nevojave për mbrojtje dhe shërbime psikosociale të fëmijëve në këtë bashki.

Si kudo në Republikën e Shqipërisë, fëmijët jetimë dhe ata nën urdhër mbrojtjeje (në rastet e dhunës në familje), përfitojnë një mbështetje financiare prej 3,000 lekë në muaj. Fëmijët pa kujdes prindëror vendosen në familje kujdestare. Deri tani, Bashkia Roskovec ka adresuar 8 raste të vendosjes së fëmijëve në familje kujdestare. Megjithatë, thuajse në të gjitha rastet kjo është siguruar përmes ofrimit të familjeve kujdestare nga radhët e të afërmve. Mungesa e një kulture të kujdestarisë përtej të afërmve, mungesa e ndërgjegjësimit si dhe pagesa jo shumë motivuese (vetëm 9,000 lekë/muaj për fëmijë), bën që identifikimi i familjeve të gatshme për të vepruar si familje kujdestare të jetë shumë i vështirë dhe një nevojë e vazhdueshme.

Fëmijët në Bashkinë Roskovec mund të shfrytëzojnë edhe mjediset e Qendrës Sociale Komunitare si dhe mundësitë, që jepen aty për ndjekjen e kurseve të ndryshme. Megjithatë, ato kanë një natyrë, që i bën më të përshtatshme për të rinjtë.

Bashkia Roskovec, deri tani, nuk ka arritur të jetë miqësore me më të vegjlit. Çerdhet mungojnë në të gjithë territorin e Bashkisë Roskovec dhe ndërtimi (i të paktën) një çerdheje është domosdoshmëri. Në Bashkinë Roskovec ka dy kopshte, të cilët mbulojnë deri diku nevojat për fëmijët në grupmoshën 3-5 vjeç, por “Kopshti 1” (i cili njihet edhe si kopshti pa drekë) ka nevojë për një restaurim të plotë. Situata është problematike dhe nevojitet ndërhyrje edhe në shkollën “Kurjan”. Nga ana tjetër, sigurimi i një sistemi ngrohjeje funksional mbetet një nevojë shumë e prekshme për të gjithë fëmijët në moshë shkollore në këtë bashki.

Bashkia Roskovec nevojitet të parashikojë dhe investojë edhe për shërbime argëtimi dhe rekreacioni për fëmijët. Deri tani, në territorin e Bashkisë Roskovec nuk ka asnjë park/kënd lojrash për fëmijët. Edhe terrenet sportive mungojnë dhe ka nevojë për një rikonsiderim të terreneve, që mund të rikonstruktohen dhe zgjerohen (për shembull ato pranë shkollave) apo për ndërtimin e terreneve të reja.

IV.2.3 Të rinjtë

Qendra Sociale Komunitare (QSK) është pika e vetme e takimit për aktivitete socio-kulturore të të rinjve të Bashkisë Roskovec. QSK ofron kurse në fotografi, gazetari dhe aktrim, me mbështetjen e organizatës “Epoka e RE”. Të rinjve iu është ofruar edhe mundësia për të mësuar se si shkruhet një CV dhe, së fundmi, në bashkëpunim edhe me Qendrën për Zhvillim Profesional – Fier, janë ofruar edhe kurse profesionale (parukeri, elektrikist etj). Rreth 20 të rinj angazhohen në secilin aktivitet të organizuar nga QSK-ja. Megjithatë, statistika të sakta për përfituesit, të shtrira në kohë, nuk ka.

Në kushtet ku papunësia tek të rinjtë është një problem madhor dhe një shkak kryesor për largimin në emigracion, vlerësohet se nevojiten ndërhyrje urgjente, që marrin në konsideratë dhe adresojnë nevojat e të rinjve për punësim dhe përfshirje sociale. Disa masa konkrete që janë sugjeruar nga anëtarë të komunitetit janë:

- Diversifikimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të QSK-së ku mund të përfshihen:
 1. Orientimi për karrierën;
 2. Kurse profesionale në përputhje me kërkesat e tregut;
 3. Aktivitete social-kulturore dhe sportive (duke shfrytëzuar edhe mjediset sportive pranë shkollave).
- Mbështetje e (vetë)punësimit të të rinjve, si për shembull mbështetje financiare dhe me lehtësira fiskale e “start-up”-eve të ideuara nga të rinjtë.
- Angazhimi i të rinjve në vendimmarrje – krijimi i një Këshilli Rinor pranë Këshillit Bashkiak.

IV.2.4 Personat me Nevoja të Veçanta (Aftësi të Kufizuar, AK)

Personat me nevoja të veçanta apo me aftësi të kufizuar në Bashkinë Roskovec nuk marrin shërbime të dedikuara prej Bashkisë. Ata bëhen përfitues të pagesës së aftësisë së kufizuar sipas vendimit të një komisioni të posaçëm, i cili vepron përtej kompetencave dhe juridiksionit të bashkisë. Megjithatë, Bashkia ka treguar ndjeshmërinë e domosdoshme në respektimin e kushteve bazë në ndërtimet infrastrukturore të viteve të fundit, si dhe në bashkëpunim me Fondacionin Shqiptar për PAK, ka siguruar herë pas herë karrige me rrota për persona në nevojë.

Raportohet se një pjesë e mirë e fëmijëve me aftësi të kufizuar janë të integruar në shkolla dhe mbështeten nga mësues të dedikuar (mësues ndihmës). Megjithatë, nevojat për shërbime të dedikuara për personat me aftësi të kufizuar mbeten të paadresuara. Personat me aftësi të kufizuar dhe veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuar detyrohen që të shkojnë në Fier për të aksesuar shërbime të domosdoshme për mirëqenien e tyre. Ngritja dhe funksionimi i një qendre ditore për personat me AK është një domosdoshmëri për të mundësuar aksesin ndaj shërbimeve bazë.

IV.2.5 Gratë (dhe viktimat e dhunës në familje/me bazë gjinore)

Bashkia Roskovec ka ndërmarrë një sërë nismash në kuadër të fuqizimit të grave dhe ardhjes në ndihmë të kategorive më në nevojë ndër to. Gjatë vitit 2018, me mbështetjen e donatorëve dhe partnerëve të saj, Bashkia Roskovec ka pasuruar shërbimet dhe nismat për mbështetjen e grave. Me mbështetjen e UNDPsë, është ngritur shërbimi i “Strehëzës së emergjencës”, e cila strehon viktimat e dhunës për 48 orë, deri në pajisjen me Urdhër të Menjëhershëm të Mbrojtjes. Po kështu, Bashkia ka staf të dedikuar për çështjet e dhunës në familje dhe barazisë gjinore dhe ka një sistem të ngritur referimi për këto raste.

Në aspektin e fuqizimit ekonomik, Bashkia Roskovec ka financuar 11 projekt propozime të grave sipërmarrëse për t’i fuqizuar dhe zhvilluar ekonomikisht dhe për të zgjeruar bizneset e tyre. Në kuadër të projektit “Sapuni Organik Roskovec”, projekt i financuar nga UNDP dhe Bashkia Roskovec, janë trajnuar 18 gra për prodhimin e sapunit nga mbetjet e vajit të ullirit. Në përfundim të këtij projekti, do të ndërtohet një biznes social ku dhe do të punësohen këto gra me qëllim për ta zgjeruar edhe më shumë këtë biznes.

Bashkia Roskovec ka organizuar edhe aktivitete sociale, që synojnë përfshirjen dhe fuqizimin e grave. Disa nga aktivitetet e organizuara gjatë vitit 2018 përfshinin: “Fushata e Aktivizimit Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave”; “Dita Ndërkombëtare e Mbështetjes së Viktimave të Dhunës dhe Kategorive në Nevojë”;

“Dita Botërore e Humanizmit”; “Depistimi i Kacerit të Gjirit” etj. Këto aktivitete janë shfrytëzuar edhe për të ndihmuar gratë në nevojë dhe gratë kryefamiljare me pako ushqimore. Bashkia Roskovec ka realizuar, ndër të tjera, edhe ndërtimin e banesave të reja për gra kryefamiljare (2 raste deri në vitin 2018).

Ndonëse i është dhënë një rëndësi e veçantë mbështetjes dhe fuqizimit të grave, Bashkia Roskovec mund të bëjë edhe më shumë duke shtuar përpjekjet për:

- Diversifikimin e kurseve profesionale të ofruara për gratë (duke iu larguar asaj çfarë është ofruar tradicionalisht si parukeri, robaqepsi etj) në përputhje me kërkesat e tregut;
- Lehtësi dhe mbështetje e (vetë)punësimit të grave si për shembull mbështetje financiare dhe lehtësira fiskale e “start-up”-eve të grave, apo përjashtimi nga detyrimet vendore për bizneset e grave;
- Nxitja dhe mbështetja e biznesit artizanal dhe gjetja/mundësimi i aksesit në treg (si për shembull, përmes organizimit të panairove të dedikuara etj.)

IV.2.6 Romët dhe egjiptianët

Bashkia Roskovec është një bashki miqësore ndaj pakicave rome dhe egjiptiane dhe ky është një perceptim që e ndajnë si aktorët ashtu edhe grupet e interesit të konsultuara gjatë procesit për hartimin e këtij dokumenti. Edhe pse pakicat rome dhe egjiptiane përbëjnë vetëm 1% të popullsisë së Bashkisë (në total 365 romë dhe vetëm 32 egjiptianë), këto pakica kanë marrë vëmendje të vazhdueshme dhe raportohen të jenë të stabilizuara, të mirë-pranuara dhe integruara me pjesën tjetër të popullsisë.

Që nga viti 2015, Bashkia Roskovec ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institutin e Kulturës Rome në Shqipëri (IRCA). Bashkia ka krijuar një bazë të dhënash dhe mbledh vazhdimisht informacion mbi pakicat rome dhe egjiptiane (të dhëna mbi vendbanimin, profesionin, arsimimin, gjendjen e punësimit etj.). Në këto komunitete janë identifikuar dhe janë aktive disa pika fokale – individë me potencial përfaqësues.

Në fushën e strehimit, në të cilën pakicat rome dhe egjiptiane kanë pasur problematika të vazhdueshme, Bashkia ka ndërhyrë me rikonstruksionin e banesave (52 banesa vetëm në periudhën 2016-2017) në kuadër të projektit “Për përmirësimin e kushteve të banimit të komunitetit rom”. Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar disa investime infrastrukturore nga të cilat përfitojnë dhe familjet rome, si në rrugën “Lagjia e Naftës” dhe “Rrugën e Varrezave” në Marinëz, si dhe në Unazën e Roskovecit. Së fundmi, ka marrë zgjidhje edhe problematika e furnizimit me energji elektrike në lagjen “Liqeni”, ku jetojnë 8 familje rome (është realizuar

pajisja e kësaj zone me një transformator të ri).

Në aspektin social dhe kulturor, Bashkia Roskovec ka vlerësuar dhe promovuar modelet pozitive prej pakicave rome dhe egjiptiane³ përmes titujve dhe çmimeve. Në raste të veçanta, Bashkia ka ofruar mbështetje teknike në procese gjyqësore apo procedurale (si p.sh për regjistrimin e fëmijëve të paregjistruar, përfitimin e pensionit të pleqërisë etj.).

Në mënyrë më të strukturuar dhe të qëndrueshme, Bashkia Roskovec është përpjekur të adresojë një nga nevojat më të mëdha të pakicave rome dhe egjiptiane – arsimimin, kualifikimin dhe punësimin. Aktualisht nuk rezultojnë të ketë probleme me braktisjen e shkollës nga komuniteti rom dhe egjiptian, megjithatë në përgjigje të nevojave të akumuluar në kohë, përmes Qendrës Sociale Komunitare, Bashkia ka mundësuar organizimin e kurseve falas për: përmirësimin e njohurive në lexim dhe shkrim të gjuhës shqipe (përfitues janë 11 persona të grupmohave të ndryshme) si dhe për gjuhë angleze (përfitues 10 fëmijë). Është lehtësuar edhe punësimi i anëtarëve të pakicës rome: 2 mësues romë; 1 lehtësues i pakicës rome është i punësuar pranë bashkisë; 4 gra dhe një burrë rom janë të punësuar në sektorin e pastrim- gjelbërimit dhe 1 i punësuar pranë kompanisë Ujësjellës Kanalizime SH.A.

Të gjitha këto nisma vlerësohen nga pakicat rome dhe egjiptiane ashtu siç evidentohen edhe nevoja dhe problematika, që kërkojnë ende përpjekje për adresim. Në fushën e strehimit, projektet e rikonstruksionit të banesave nuk adresojnë dot problemet me mungesën totale të stehimit. Për këtë kërkohet të planifikohet ndërtimi i banesave sociale, ku romët dhe egjiptianët të kenë akses. Po në aspektin e shërbimeve infrastrukturore dhe aksesit në shkollë, nevojitet sigurimi i transportit për fëmijët e vegjël, që banojnë në zonën e Liqenit dhe që në periudhën e dimrit kanë vështirësi të aksesojnë shkollën në qytet.

Në aspektin e sigurisë dhe përfshirjes ekonomike, shumë famije rome janë përjashtuar nga skema ekonomike dhe gjenden në vështirësi dhe të painformuar mbi arsyet dhe kriteret e përdorura. Disa prej tyre përballen edhe me gjoba dhe kamatë vonesa për gjoba për kalimin e parregullt të kufirit në kërkim të punës (kryesisht në Greqi). Punësimi është mjaft i vështirë për këto pakica si pasojë e nivelit të ulët të arsimimit dhe kualifikimit, por edhe e aksesit të kufizuar në shërbimet e punësimit, të cilat aktualisht duhet t'i marrin në Fier. Nevojitet hapja e një Zyre Pune (apo nëndege të saj), e cila është operacionale pranë banorëve të

3 Bashkia Roskovec ka dhënë titullin "Artizani më i mire, 2017" gjatë ceremonisë në eventin e përvitshëm "Njeriu i Vitit". Ky titull i është dhënë z. Ramiz Sheme, nga minoriteti rom. Me vendim të Këshillit Bashkiak është shpallur "Qytetar i Nderit" kompozitori Tofik Sheme, gjithashtu nga minoriteti rom në Roskovec.

Bashkisë Roskovec.

Sigurimi i dëshmime ekuivalente me kryerjen e arsimit të detyrueshëm janë një nevojë tjetër e menjëhershme për të mundësuar aksesin dhe suksesin në kurset profesionale. Punësimi mund të mbështetet dhe inkurajohet edhe përmes përjashtimit të aktiviteteve prodhuese të anëtarëve të këtyre pakicave nga taksat vendore, për një periudhë të kufizuar deri në fuqizimin e aktivitetit.

IV.2.7 Familjet e kthyer nga emigrimi/azili

Ndonëse familjet e kthyer nga emigracioni kanë ardhur duke u shtuar, pak njihet dhe raportohet mbi problematikat e tyre. Në përgjithësi, mendohet se ato kthehen në banesat që kanë në pronësi dhe janë në gjendje ekonomike të mirë. Një pjesë e tyre kanë investuar në bujqësi përmes krijimit të serave. Për ta nevojta kryesore lidhet me sigurimin e tregut. Më problematike paraqitet situata e emigrantëve sezonalë dhe atyre të rikthyer nga azil-kërkimi. Ri-integrimi i fëmijëve në shkollë dhe i të rriturve në tregun e punës janë sfidat kryesore për këto grupe.

IV.3 Partneriteti me OJF-të dhe aktorë të tjerë

OJF-të kanë një rol shumë të rëndësishëm në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve në vend. Një faktor mjaft pozitiv është përfshirja e tyre në hartimin dhe konsultimin e shumë prej strategjive vendore dhe kombëtare. Gjithashtu ato kanë rol thelbësor në hartimin e politikave dhe shpërndarjen e shërbimeve shoqërore. OJF-të vendore kanë kontribuar shpesh në adresimin apo referimin me sukses të rasteve apo çështjeve, të cilat kanë paraqitur sfida për strukturat e qeverisjes vendore. Bashkia Roskovec ka burime të kufizuara edhe në këtë aspekt.

Në territorin e Bashkisë së Roskovec operon vetëm një organizatë vendore “Gruaja, Komuniteti, Mjedis - Harmonizuar për Zhvillim”. Kjo organizatë zbaton projekte të ndryshme në Roskovec, në fokus të të cilave janë gratë dhe të rinjtë e qytetit të Roskovecit.

Bashkia Roskovec gjithashtu ka bashkëpunuar dhe me organiza të tjerë si:

- UNDP
- USAID
- Social Development Investment
- Fondacioni për Qeverisje dhe Autonomi Vendore (FLAG)
- Epoka e Re

Sektori i Shërbimit Social gjithashtu bashkëpunon me këto organizata. Deri tani, SSHS-ja nuk ka një marrëveshje të firmosur bashkëpunimi me to. Ndonëse roli i tyre vlerësohet si shumë i frytshëm nga SSHS-ja dhe aktorët e tjerë, numri i tyre është i pakët dhe ato ofrojnë shërbime të kufizuara në kapacitete, llojshmëri e mbulim dhe janë në përgjithësi të paqëndrueshme. Gjithashtu, nga të dyja palët raportohet, krahas bashkëpunimit, edhe mungesa në këtë drejtim, që vihen re në mosraportimin e OJF-ve ndaj bashkisë nga njëra anë, si dhe marrjen përsipër të koordinimit të vazhdueshëm të aktorëve të duhur në fushë.

Edhe pse OJF-të vendore janë shumë të rralla, Bashkia Roskovec duhet të përgatitet dhe ndërtojë sisteme dhe mekanizma referimi të cilat të përfshijnë edhe OJF- të vendore si aktorë shumë të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve sociale. Ato konsiderohen si një strukturë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve, pasi mund të veprojnë edhe më shpejt se institucionet publike dhe kanë mundësi për të ofruar një cikël të plotë të shërbimeve. Nga ana tjetër, organizatat janë gjithmonë në kërkim të fondeve dhe burimeve dhe në varësi të disponueshmërisë së tyre, ato nuk janë gjithmonë aktive. Në lidhje me punën e organizatave deri tani nuk është hartuar ndonjë marrëveshje formale apo ndonjë plan bashkëpunimi, pa përcaktuar kështu ndonjë përgjegjësi. Është e nevojshme ekzistenca e një vullneti të fortë nga vendimmarrësit për të zhvendosur këtë qasje të rëndësishme së bashku me ndryshimet në ligjin e prokurimit publik.

V. Misioni, vizioni dhe objektivat

V.1 Misioni

Bashkia e Roskovecit synon të konsolidojë Sektorin e Shërbimeve Sociale (SSHS) dhe të ofrojë më shumë shërbime të standardizuara dhe cilësore të kujdesit shoqëror, për të mbuluar nevojat sociale në rritje, të grupeve në nevojë dhe komunitetit në tërësi. Ky mision synon të përmbushet përmes zhvillimit të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror, ndërtimit të shërbimeve të reja dhe shpërndarjes së tyre sa më pranë qytetarëve, sipas modeleve të praktikave të mira bashkëkohore.

V.2 Vizioni

Shërbimet sociale në Bashkinë Roskovec janë gjithëpërfshirëse, të larmishme, të shpërndara në territor, në përputhje me nevojat e komunitetit, me standarde, të besueshme dhe pranë njerëzve. Nevojat e popullatës së Bashkisë janë të njohura, të vlerësuara dhe të dhënat e tyre ushqejnë planifikimin dhe zbatimin e politikave sociale të Bashkisë. Bashkia maksimizon efijencën e përdorimit të burimeve për një mbulim sa më të mirë të nevojave materiale të tyre, si dhe një mbulim më të plotë me shërbime të tjera të përkujdesit shoqëror, sipas një qasjeje me personin në qendër, multisektoriale dhe të menaxhimit të rastit, duke vënë në dispozicion burime njerëzore, materiale dhe financiare të mjaftueshme për ta siguruar këtë.

V.3 Objektiva strategjike dhe specifike

Plani Vendor i Përfshirjes Sociale i Bashkisë Roskovec (2019-2022) është një dokument politikash specifike për grupet dhe komunitet e synuara në territorin e Bashkisë, në përputhje të plotë me Strategjinë e Mbrojtjes Sociale (2015-2020) dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2015-2020), dhe detyrimeve e përgjegjësiqe që burojnë nga Ligji për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror, me Paktin Social të firmosur nga Kryetarët e Bashkive të Republikës së Shqipërisë me përfaqësues të Qeverisë, si dhe Vendimet e Këshillit të Ministrave⁴ që sigurojnë

4 Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social".

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror

legjislacionin sekondar në mbështetje dhe zbatim të ligjeve të sipër-përmendur. Ky Plan do të jetë pjesë përbërëse/integrale e Planit të Zhvillimit të Bashkisë Roskovec dhe në këtë kuadër do t'i mundësojë strukturave vendimmarrëse të Bashkisë të përcaktojnë fushat prioritare dhe shpërndarjen e burimeve të disponueshme.

Plani Vendor i Përfshirjes Sociale, synon të krijojë mekanizmat e domosdoshëm administrativë, strukturat institucionale në shërbim të grupeve në nevojë, të identifikojë kostot dhe burimet financiare, në mënyrë që shërbimet e kujdesit social të ofrohen për familjet, fëmijët dhe grupet e tjera në nevojë në Bashkinë Roskovec, sipas një projekti të hartuar mirë, i cili monitorohet dhe përditësohet rregullisht. Dokumenti i Planit Social synon të jetë dokument orientues i mbështetjes nga donatorët, nga OJF-të, që udhëheq vendimmarrjen e bashkisë për të siguruar çdo mbështetje institucionale, logjistike dhe financiare ndaj SSSHs, që në bashkinë e Roskovecit grupet në nevojë të trajtohen sipas parashikimeve ligjore, dhe jo në mënyrë të improvizuar, të sforcuar dhe me vështirësi subjektive.

Më konkretisht, objektivat e këtij plani janë:

Objektivi strategjik 1. Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi, koordinimi dhe vlerësimi i shërbimeve shoqërore në Bashkinë Roskovec

- Objektivi specifik 1. Ndërtimi dhe forcimi i njësisë (drejtorisë) së shërbimeve sociale/shoqërore
- Objektivi specifik 2. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative
- Objektivi specifik 3. Ndërtimi i hartës së vulnerabilitetit dhe të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror
- Objektivi specifik 4. Zhvillimi i monitorimit dhe vlerësimit
- Objektivi specifik 5. Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ngritja e shërbimeve të reja

komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes”.

Udhëzim i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018 “Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore”.

Objektivi strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit

- Objektivi specifik 1. Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë
- Objektivi specifik 2. Fuqizimi ekonomik përmes nxitjes dhe lehtësimit të punësimit

Objektivi strategjik 3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara

- Objektivi specifik 1. Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara me shërbime

Objektivi strategjik 4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre

- Objektivi specifik 1: Fuqizimi i NJMFsë dhe administratorëve socialë në çdo njësi
- Objektivi specifik 2 – Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësisë të stafit të angazhuar në role dhe detyra për MF
- Objektivi specifik 3 – Përforsimi i shërbimit psiko-social në shkolla
- Objektivi specifik 4 – Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje
- Objektivi specifik 5 – Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e kujdesit shoqëror (dhe të mbrojtjes së fëmijëve)

Objektivi strategjik 5 – Mbrojtja e të moshuarve dhe të drejtave të tyre

- Objektivi specifik 1: Ngritja e Qendrës Ditore dhe Rezidenciale për të moshuarit në nevojë

Objektiv strategjik 6 – Përmirësimi i politikbërjes, vendimmarrjes dhe planifikimit në fushën e shërbimeve shoqërore përmes mbështetjes në evidencë dhe pjesëmarrjes së grupeve të synuara

Objektivi specifik 1 – ngritja e mekanizmave të konsultimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të synuara në proceset vendimmarrëse të Bashkisë

VI. Plani i veprimit

Objektivi strategjik 1. Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi, koordinimi dhe vlerësimi i shërbimeve shoqërore në Bashkinë Roskovec

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Buxheti ¹	Monitorimi
Objektivi specifik 1. Ndërtimi dhe forcimi i njësisë (drejtorisë) së shërbimeve sociale/shoqërore						
Ristrukturimi i organigramës së Bashkisë Roskovec	Drejtoria e Burimeve Njerëzore	2020	Numri i NJVNR të ngritura në raport me numrin e NJA-ve në zone (sipas ligjit)	Bashkia Roskovec DBNJ	97,000	MSHKS DBNJ SSHs
			Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore			
			NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore			

<p>Ngritja e Drejtorisë së Shërbimeve Sociale</p>	<p>Drejtoria e Burimeve Njerëzore</p>	<p>2021-2022</p>	<p>Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore</p> <p>Numri i NJVNR të ngritura në raport me numrin e NJA-ve në zone (sipas ligjit)</p> <p>NJVNR e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore</p>	<p>Bashkia Roskovec DBNJ</p>	<p>3,264,000</p>	<p>SSH</p>
<p>Aktivite informuese me aktorët përgjegjës në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror mbi punën e SSHS-së në ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në këtë fushë</p>	<p>SSH Institucionet përgjegjëse</p>	<p>2020-2022</p>	<p>Numri i institucioneve pjesëmarrëse në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse sipas ligjit</p>	<p>Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>489,984</p>	<p>SSH</p>

Objektivi specifik 2. Ngritja e Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit në çdo njësi administrative

Rishikimi i strukturës për çdo njësi administrative sipas numrit të popullsisë dhe nevojave për shërbime	SSH DBNJ	2019- 2020	Struktura përgjegjëse e organizuar në numër dhe funksione sipas parashikimeve ligjore	SSH DBNJ OJF-të	185,600	SSH DBNJ
Përpilimi, diskutimi dhe miratimi i përshkrimeve të punës.	SSH DBNJ	2020	Rregullorja e Bashkisë përmban përshkrim të ri pune për strukturën përgjegjëse, NJVRN dhe çdo specialist sipas parashikimeve ligjore	DBNJ	232,000	SSH

Objektivi specifik 3. Ndërtimi i hartës së vulnerabilitetit dhe të shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror						
Vlerësimi i nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror në çdo njësi administrative.	OJF	2019	Dokumenti i hartuar – harta e shërbimeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel Bashkie dhe njësie administrative;	Bazë të dhënash e krijuar për shërbimet e kujdesit shoqëror, Bashkia Roskovec	300,000	SSHS Sektori Menaxhimit të Projekteve
Ndërtimi, pasurimi dhe përmirësimi i hartës së shërbimeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel Bashkie dhe njësie administrative; Ngritja e sistemit të regjistrimit të aplikimeve/ nevojave me të dhëna sa më të dizagreguara	SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve	2019	Dokumenti i hartuar – harta e shërbimeve ekzistuese të shërbimeve të kujdesit shoqëror në nivel Bashkie dhe njësie administrative	Bazë të dhënash e krijuar për shërbimet e kujdesit shoqëror, Bashkia Roskovec	142,800	SSHS Sektori Menaxhimit të Projekteve

Pasqyrimi në faqen në internet të Bashkisë të hartave të shërbimeve sociale për Bashkinë dhe njësitë e saj.	Specialisti IT-së	2019	Baza e të dhënave e hartuar do të publikohet në faqen zyrtare të Bashkisë Roskovec	Faqja zyrtare e Bashkisë Roskovec Raporte monitorimi të përditësimit të saj nga OJF-të	326,400	SSH Sektori Menaxhimit të Projekteve Kordinatori i të Drejtës për Informim
Objektivi specifik 4. Zhvillimi i monitorimit dhe vlerësimit						
Monitorimi dhe vlerësimi i zbatimit të Fondit Social	SSH	2020	Dokumenti i procedurave Raporte 4 mujore dhe raporte 1 vjeçare	Raporte monitoruese Bashkia Roskovec OJF-të	102,000	SSH

Objektivi specifik 5. Përmirësimi i shërbimeve ekzistuese të kujdesit shoqëror dhe ngritja e shërbimeve të reja						
Objektivi specifik 5.1. Mbështetja dhe fuqizimi i shërbimeve ekzistuese						
Shtimi i stafit dhe kapaciteteve të Qendrës Sociale Komunitare	DBNJ Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale	2021-2022	Numri i punonjësve të shtuar në strukturën e Bashkisë pranë Qendrës Social Komunitare	Organogrami e Bashkisë Roskovec	3,672,000	DBNJ Sektori i Menaxhimit të Projekteve
Rritja e kapacitetit të QSK dhe pasurimi i aktivitetit social të saj – shtimi i shërbimeve për të rinjtë, gratë, të moshuarit, pakicat rome dhe egjiptiane, grupet e marginalizuara.	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale	2020-2022	Numri i aktiviteteve të organizuara me grupe të synuara	Bashkia Roskovec OJF-të	800,000	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve
Objektivi specifik 5.2. Fuqizimi i Strehëzës së Emergjencës (për Viktimat e Dhunës në Familje dhe Fëmijë, familje të rikthyera në situata emergjente etj.) dhe ngritja e strukturës për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje (ÇBGJDFH).						
Vlerësimi i nevojave për fuqizimin e strehëzës së emergjencës për t'u ardhur në ndihmë edhe fëmijëve apo qytetarëve të tjerë në situatë rruge (përshtatja e Qendrës së Emergjencës)	SSH OJF	2020	Dokumenti i vlerësimit të nevojave	Legjislacioni përkatës në fuqi	270,000	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve

<p>Aktivite informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje mbi punën e strukturës së CBGJDHF – së dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe adresimin e çështjeve gjinore</p>	<p>SSHS Strehëza NJA CBGJDHF</p>	<p>2019 – 2022</p>	<p>Numri i qytetarëve pjesëmarrës në aktivitetet, në raport me numrin e qytetarëve në zonë</p> <p>Numri i institucioneve/ punonjësve pjesëmarrës në raport me numrin e institucioneve përkatëse/ punonjësve relevantë</p>	<p>SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve</p>	<p>400,000</p>	<p>SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve</p>
<p>Pasurimi i kapaciteteve dhe shërbimeve të Strehëzës</p>	<p>CBGJDHF</p>	<p>2021- 2022</p>	<p>Infrastrukturë e përmirësuar dhe numri i shërbimeve të ofruara në krahasim me shërbimet që ofroheshin</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi</p>	<p>100,000</p>	<p>SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve</p>

Objektivi strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
Objektivi specifik 1. Mbështetja dhe fuqizimi i familjeve në nevojë						
Identifikimi dhe menaxhimi i rasteve të familjeve në nevojë, të cilat nuk përfitojnë nga skema e NE	SSH Administratorët Shoqërorë	Çdo muaj	Numri i familjeve të identifikuara Numri i familjeve të referuara tek punonjësi social Numri i planeve dhe ndërhyrjeve individuale për çdo familje të referuar Rastet e referuara nga punonjësi social	Raportet nga sistemi MIS i NE; Vendimi për listën e përfutuesve nga NE Vlerësimi social-ekonomik nga administratorët për familjet jo-përfituese	2,672,640	SSH

<p>Qartësim/Miratimi i kriterëve për përzgjedhjen e familjeve, që do të përfitojnë nga 6% dhe fondet e Bashkisë</p>	<p>Këshilli Bashkiak Roskovec Administratorët shoqërorë/NJA SSH DF</p>	<p>2019</p>	<p>Lista e kriterëve të përzgjedhjes Numri i familjeve përfutuese në raport me numrin e familjeve të identifikuar</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi për NE Elementët e identifikuar si nevoja nga raportet e administratorëve shoqërorë Bashkia Roskovec</p>	<p>11,600</p>	<p>SSH</p>
<p>Mbështetja emergjente për nevojat bazë materiale të familjeve në nevojë (bazuar mbi vlerësimin socio-ekonomik)</p>	<p>SSH OJF</p>	<p>Në vazhdimësi</p>	<p>Numri i familjeve të mbështetura në raport me numrin e familjeve në nevojë për mbështetje</p>	<p>Sistemi i NE Vlerësimi socio-ekonomik i administratorëve shoqërorë në çdo NJA, Bashkia Roskovec Raporte të OJF-ve</p>	<p>480,000</p>	<p>SSH OJF</p>

<p>Ngritja e shërbimeve të reja ditore për fëmijë (çerdhe) duke vlerësuar nevojat dhe duke u dhënë përparësi zonave me varfëri dhe papunësi të lartë</p>	<p>SSHHS</p>	<p>2020 - 2022</p>	<p>Kapaciteti/numri i fëmijëve i çerdheve të ngritura/rehabilituara në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim</p> <p>Kapaciteti/numri i fëmijëve i kopshteve të ngritura/rehabilituara në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim</p>	<p>SSHHS</p>	<p>22,130,000</p>	<p>SSHHS</p>
<p>Përcaktimi i kuotave për kopshte dhe çerdhe për fëmijët në nevojë për mbrojtje (fëmijë në situatë rruge në veçanti, R&E), të paktën 5 fëmijë</p>	<p>SSHHS</p>	<p>2020</p>	<p>VKB për përcaktimin e kuotave Numri i fëmijëve që përfitojnë nga kuotat në raport me numrin e fëmijëve në nevojë për këtë shërbim</p>	<p>SSHHS NJA</p>	<p>138,000</p>	<p>SSHHS</p>

Ndërtimi i bane- save sociale për strehimin e familje- ve të pastreha (me përparësi familjet me fëmijë, pakicat rome dhe egjiptia- ne, gratë kryefa- miljare).	SSH MFE	2020 – 2022	Numri i familjeve (dhe fëmijëve) të pastreha që futen në banesa sociale/	SSH	23,000,0000	SSH
Rehabilitimi i shtëpive që rrezikojnë shën- detin dhe jetën e fëmijëve pa kufizim nga aftësia e prindërve për të siguruar strehim ose për të plotë- suar kriteret për strehim social.	SSH MFE	2019- 2022	Numri i shtëpive të rehabilituara në raport me numrin e familjeve (dhe fëmijëve) që kanë nevojë	SSH	96,000,000	SSH

Objektivi specifik 2. Fuqizimi ekonomik përmes nxitjes dhe lehtësimit të punësimit						
Hapja e Zyrës së Punës në Roskovec (ose degë)	MFE	2019-2022	Hapja dhe funksionimi i një dege të Zyrës së Punës në Roskovec	Marrëveshja e bashkëpunimit Ministria e Financës dhe Bashkia Roskovec	5,184,000	MFE Bashkia Roskovec
Financimi i bizneseve të rinj ("start-ups") nga anëtarë të grupeve në nevojë (të rinj, gra, romë dhe egjiptianë etj.)	Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale	2019-2022	Thirrje publike të hapura për financim të bizneseve të rinj. Numri i përfuturseve	Thirrjet Publike për projekt ide Sektori i Menaxhimit të Projekteve Sociale	4,000,000	Sektori i Menaxhimit të Projekteve
				Raportet përkatëse, Bashkia Roskovec		
				OJF-të		

Objektivi strategjik 3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
Objektivi specifik 1. Mbështetja e personave me aftësi të kufizuara me shërbime						
Ngritja e qendrës për shërbime për PAK	Sektori i Menaxhimit të Projekteve SSHS	2019-2022	Krijimi i infrastrukturës së përshtatshme pranë Qendrës Social Komunitare për personat me aftësi të kufizuara	Bashkia Roskovec	7,500,000	SSHs Sektori i Menaxhit të Projekteve
			Llojet dhe shtrirja e shërbimeve të ofruara	Dokumente/ raporte të vetë qendrës OJF-të		
			Numri i përfituesve (disagreguar sipas gjinisë, grupmoshave, etnive etj.)			
			Raporti kërkesë për shërbime / nevoja të mbuluara.			
Trajnimi i stafit	MSHMS OJF	2019-2022	Numri i trajnimeve të ofruara nga MSHMS si dhe nga aktorë të tjerë	Bashkia Roskovec, DBNJ MSHMS	816,000	SSHs DBNJ
			Numri i pjesëmarrësve			
			Llojet e tematikave të trajtuara			

Objektivi strategjik 4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
Objektivi specifik 1: Fuqizimi i NJMF dhe administratorëve socialë në çdo njësi						
Ngritja e kapaciteteve të administratorëve socialë, NJVRN-së, NJMF-së dhe SCGJDHF-së (trajtime, mentorime, për funksionimin e NJVRN, zbatimin dhe monitorimin e Fondit Social, zbatimin e modelit pilot të ofrimit të shërbimeve në familje, funksionimin e shërbimit të Strehëzës, funksionimin e Qendrës Rinore, funksionimin e modelit pilot të shërbimeve për personat PAK).	SSHHS	2019- 2022	Modulet e trajnimeve të zhvilluara Numri i stafit të trajnuar në raport me numrin e stafit që ka nevojë për trajnim Numri i tematikave të mbyllura për fushë/kategori përfituesish	Bashkia Roskovec, SSHS OJF-të	544,000	SSHHS

<p>Ngritja e Grupit Teknik Ndërsëktorial (GTN) të trajtimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (në NJA –të me mbi 3000 fëmijë) dhe forcimi i punës së GTN</p>	<p>SSH Institucionet përgjegjëse, pjesë e GTN-së</p>	<p>2019-2022</p>	<p>Dokumenti i miratimit të GTN Numri i takimeve të GTN-së në raport me numrin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që ndiqen nga GTN Numri i takimeve të GTN Numri i pjesëmarrësve në çdo takim Minutat/raportet e takimeve</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>371,200</p>	<p>SSH OJF-të</p>
<p>Aktivite informuese me institucionet vendore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve (përfaqësues në GTN) mbi punën e NJMF-së dhe detyrimet ligjore e institucionale reciproke në mbrojtjen e fëmijëve dhe rreth njohurive për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje</p>	<p>SSH Institucionet përgjegjëse, pjesë e GNT</p>	<p>2019- 2022</p>	<p>Numri i institucioneve pjesëmarrëse në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse sipas ligjit Numri i punonjësve pjesëmarrës në çdo aktivitet në raport me numrin e punonjësve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në çdo institucion</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>400,000</p>	<p>SSH</p>

Objektivi specifik 2 – Përcaktimi i detyrave dhe përgjegjësi të stafit të angazhuar në role dhe detyra për MF

<p>Prezantimi dhe vënia në dispozicion e të gjithë profesionistëve/institucioneve përgjegjëse i të gjitha formave të dokumentimit për identifikimin dhe raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje dhe me detyrimet ligjore përkatëse.</p>	SSHHS	2019	<p>Numri i formave të shpërndara në raport me numrin e formave ekzistuese të dokumentimit sipas ligjit</p> <p>Numri i formave të shpërndara në raport me numrin e institucioneve përgjegjëse (elektronikisht ose në formë të printuar)</p> <p>Çdo dosje e PMF për një fëmijë në situatë për mbrojtje përmban të gjitha format e mësipërme të plotësuar</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec</p> <p>OJF-të</p>	102,080	SSHHS
<p>Ngritja e skuadrave të lëvizshme, në bashkëpunim me partnerët dhe skuadrat e shërbimeve për identifikimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kërkojnë identifikim proaktiv (fëmijët në situatë rruge, të shfrytëzuar ekonomisht, fëmijët në rrezik për trafikim/viktima të trafikimit, etj)</p>	SSHHS OJF	2020	<p>Numri i skuadrave të ngritura në raport me numrin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, që kërkojnë identifikim proaktiv përgjatë vitit të mëparshëm</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec</p> <p>OJF-të</p>	50,000	SSHHS

<p>Krijimi i bazës logjistike të nevojshme për lëvizshmërinë dhe produktivitetin e strukturave përgjegjëse për realizimin e identifikimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje (sigurimi i mjeteve të transportit dhe komunikimit)</p>	<p>SSH</p>	<p>2020-2022</p>	<p>Numri i mjeteve të transportit dhe sasia e karburantit në dispozicion në raport me nevojën për identifikim të rasteve (zona e mbulimit, numri i fëmijëve në nevojë); Mjetet e komunikimit në dispozicion (telefon, kartë, numër telefoni me kontratë), në raport me nevojën për komunikim Numri/kohëzgjatja e transportit/komunikimit të realizuar Numri i përfituesve të arritur përmes tyre (i dizagreguar)</p>	<p>NJMF dhe DF Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>150,000</p>	<p>SSH</p>
---	------------	------------------	--	--	----------------	------------

<p>Afshimi i dukshëm i numrave të kontaktit për raportimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, në të gjitha institucionet përkatëse, publike dhe jopublike dhe mjediset komunitare</p>	SSHHS	2020=2022	<p>Numri i afshimeve të dukshme në raport me numrin e institucioneve përkatëse publike dhe jopublike</p> <p>Numri i afshimeve të dukshme në raport me numrin e mjedisve komunitare në zonë</p> <p>Numri i komuniteteve/ familjeve/ individëve të synuar dhe mbuluar.</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec</p> <p>OJF-të"</p>	36,000	SSHHS
--	-------	-----------	--	--	--------	-------

Objektivi specifik 3 – Përforcimi i shërbimit psiko-social në shkolla						
Shtimi i stafit psiko-social të kualifikuar	Ministria e Arsimit	2020	Numri i punonjësve socialë dhe psikologëve në shkollat e Bashkisë Roskovec	Rregullorja e Brendshme e Bashkisë Struktura e Bashkisë Roskovec Psikologë të punësuar në raport me numrin e nxënësve	5,040,000	SSHHS

Objektivi specifik 4 – Rritja e efektivitetit në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje					
Ofrimi i shërbimit 24 orësh për përgjigjen ndaj nevojave emergjente të fëmijëve në nevojë për mbrojtje	SSHS NJA	2022	Shërbimi 24-orësh është i ngritur dhe funksional Numri i rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje që kanë marrë përgjigje menjëherë me momentin e prezantimit të nevojës në raport me numrin e rasteve të fëmijëve me nevoja emergjente	Legjislacioni përkatës në fuqi	2,937,600
				Ligji “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”	SSHS
Hartimi dhe zbatimi i PIM për çdo fëmijë të identifikuar si në nevojë për mbrojtje	SSHS	2020	Numri i PIM të hartuar dhe zbatuar në raport me numrin e fëmijëve të identifikuar si në nevojë për mbrojtje Raporti masa të parashikuara/masa të zbatuara	NJMF, Bashkia Roskovec	116,000
				OJF-të	SSHS

<p>Pjesëmarrja e fëmijës dhe familjes përgjatë çdo hapi të procesit të menaxhimit të rastit (që nga identifikimi/raportimi deri tek mbyllja e rastit)</p>	<p>SSHS</p>	<p>2020-2022</p>	<p>Numri i rasteve të ndjekura me këtë qasje Numri i takimeve me pjesëmarrje të dokumentuar të fëmijës dhe familjes në raport me numrin e takimeve të realizuar për menaxhimin e rastit ku pjesëmarrja e tyre është e detyrueshme sipas ligjit</p>	<p>NJMF, Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>417.600</p>	<p>SSHS</p>
<p>Ofrimi i këshillimit psikologjik individual për çdo fëmijë në nevojë për mbrojtje që i nevojitet ky shërbim (përmasa punonjësve të qendrave komunitare publike, të OJF-ve bashkëpunuese, sa herë që është e mundur apo në mungesë të sigurimit të tyre, përmasa marrëveshjeve me ofrues privatë të shërbimeve)</p>	<p>SSHS OJF</p>	<p>2020-2022</p>	<p>Numri i rasteve të trajtuara me këtë shërbim Raporti i tyre me numrin e rasteve në nevojë për këtë shërbim Numri i marrëveshjeve me ofrues publikë dhe jopublikë të këtij shërbimi (nëse ka)</p>	<p>Legjislacioni përkatës në fuqi Ligji "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve"</p>	<p>315,000</p>	<p>SSHS</p>

Objekti specifik 5– Rritja e informimit institucional e komunitar mbi shërbimet e kujdesit shoqëror (dhe të mbrojtjes së fëmijëve)

Afishimi i detyrimeve të institucioneve për raportimin e dhunës ndaj fëmijës në çdo institucion përgjegjës, publik ose jopublik	SSHHS	2019	Numri i afishimeve në raport me numrin e institucioneve përkatëse, publike dhe jopublike	Bashkia Roskovec Institucionet e përfshira OJF-të	20,000	SSHHS
Krijimi i seksionit të legjislacionit të përditësuar të mbrojtjes së fëmijëve në faqet zyrtare të çdo institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe seksioni në bashki (institucionet qendrore dhe vendore) sidomos të procedurave, afateve të veprimit në mbrojtje të fëmijëve etj.	SSHHS Institucionet përgjegjëse	2019	Legjislacioni i mbrojtjes së fëmijëve është i publikuar në faqen zyrtare të çdo institucioni përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve dhe është i përditësuar	Bashkia Roskovec	51,000	SSHHS

<p>Aktivitete informuese me institucionet përkatëse (arsim, shëndetësi, polici, etj) dhe me komunitetin, lidhur me shërbimet ekzistuese dhe të reja të kujdesit shoqëror dhe për mbrojtjen e fëmijëve, të drejtat e qytetarëve për shërbime, të drejtat e fëmijëve për mbrojtje, autoritetet për mbrojtje dhe përgjegjësitë përkatëse etj.</p>	<p>SSHHS Institucionet përgjegjëse</p>	<p>2019- 2022</p>	<p>Numri i institucioneve pjesëmarrëse në raport me numrin e institucioneve publike e jopublike për mbrojtjen e fëmijëve në zonë Numri i punonjësve pjesëmarrës në çdo aktivitet në raport me numrin e punonjësve përgjegjës për shërbimet e kujdesit shoqëror/ mbrojtjen e fëmijëve në çdo institucion. Numri i qytetarëve pjesëmarrës në raport me numrin e prindërve/ fëmijëve/qytetarëve në zonë</p>	<p>Bashkia Roskovec OJF-të</p>	<p>450,000</p>	<p>SSHHS</p>
--	--	-------------------	--	------------------------------------	----------------	--------------

<p>Përgatitja dhe shpërndarja e broshurave informuese mbi shërbimet ekzistuese dhe të reja për kujdesin shoqëror dhe mbrojtjen e fëmijëve, autoritetet përgjegjëse dhe të drejtat e qytetarëve për shërbime dhe të drejtat e fëmijëve për mbrojtje (në bashki, NJA, mjedise publike, institucione publike dhe OJF përkatëse, etj)</p>	SSHHS	2019 - 2022	<p>Numri i materia- leve informuese të produhuara dhe shpërndara Numri i shërbime- ve ekzistuese dhe të reja, autoriteteve përgjegjëse dhe të drejtave të fëmi- jëve për mbrojtje të përfshira në broshura në raport me numrin e tyre sipas ligjit. Numri i materia- leve informuese të shpërndara në raport me numrin e prindërve/ fëmijëve/qyte- tarëve në zonë</p>	<p>Bashkia Roskovec OJF-të</p>	600,000	SSHHS
---	-------	-------------	---	---	---------	-------

Objektiv strategjik 5: Mbrojtja e të moshuarve dhe të drejtat e tyre

Objektivi specifik 1 - Ngritja e Qendrës Ditore për të moshuarit në nevojë						
Zhvillimi dhe miratimi i koncept-modelit të menaxhimit të Qendrës	Donatorë	2019	Rregullorja e brendshme VKB	Legjislacioni përkatës në fuqi në	180,000	SSH IPSHS
Krijimi i protokolleve operative të Qendrës	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve	2019	Dokumenti i protokolleve	Legjislacioni përkatës në fuqi Partnerë vendor publikë dhe jopublikë	180,000	SSH
Përshtatja e ambjentëve të Qendrës Social Komunitare për të moshuarit (Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit mes partnerëve, nëse ka)	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve	2020-2022	Numri i përfituesve në raport me numrin e të moshuarve në nevojë për këtë shërbim Kategoritë e shërbimeve dhe programeve të ngri-tura në raport me ligjin Numri i stafit përfitues në raport me ligjin Burimet e dedikuara për këtë qëllim në raport me numrin e të moshuarve në nevojë për këtë shërbim Dokumenti i marrëveshjes (nëse ka) VKB Numri i përfituesve	Raportet nga: Bashkia Roskovec OJF-të	1,000,000	SSH Sektori i Menaxhimit të Projekteve

Aktivitetet informuese për komunitetet e zonave	SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve	2019 – 2022	Numri i qytetarëve pjesëmarrës në aktivitetet, në raport me numrin e qytetarëve. Numri i institucioneve/punonjësve pjesëmarrës në raport me numrin e institucioneve/punonjësve përkatës	Listë prezencia Foto nga aktivitetet SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve OJF-të	3,600,000	SSHS Sektori i Menaxhimit të Projekteve
---	--	-------------	--	---	-----------	--

Objektiv strategjik 6 – Përmirësimi i politikëbërjes, vendimmarrjes dhe planifikimit në fushën e shërbimeve shoqërore përmes mbështetjes në evidencë dhe pjesëmarrjes së grupeve të synuara

Aktivitetet	Aktorët përgjegjës	Afatet	Treguesit	Burimi i të dhënave	Financimi	Monitorimi
Objektivi specifik 1 – ngritja e mekanizmave të konsultimit dhe pjesëmarrjes së grupeve të synuara në proceset vendimmarrëse të Bashkisë						
Ngritja e Bordit të Qytetarëve në vendimmarrje (përfaqësues të rinj, gra, pakica rome dhe egjiptiane, të moshuar, grupet në nevojë)	Sektori i Menaxhimit të Projekteve OJF-të	2020-2022	Numri i të rinjve, grave, përfaqësuesve të pakicave rome dhe egjiptiane, pjesëmarrës dhe aktiv në bordin (qytetar)	Dokumenta për krijimin e bordit rinor Numri i përfaqësuesve aktiv në vendimmarrje	1,044,000	Sektori i Menaxhimit të Projekteve

VII. Strategjia e zbatimit

Koordinimi

SSHS-ja do të ngrejë një grup pune, i cili do të bashkërendojë zbatimin e masave dhe do të raportojë mbi Planin e Përfshirjes Sociale. SSHS-ja ka edhe përgjegjësinë e koordinimit lidhur me zbatimin e planit.

Monitorimi dhe vlerësimi

Qëllimi i monitorimit dhe vlerësimit është të sigurojë që Plani Vendor i Përfshirjes Sociale i Bashkisë Roskovec po zbatohet sipas afateve dhe synimeve të caktuara dhe për të kontrolluar pajtueshmërinë e standardeve të përcaktuara me ato që po zbatohen në realitet.

Përgjegjësia për monitorimin

Njësia kryesore përgjegjëse për monitorimin do të jetë sektori/drejtorja e shërbimeve sociale në Bashkinë Roskovec. Aktorë të tjerë që do të përfshihen në monitorim, sipas aktiviteteve specifike përfshijnë drejtoritë/sectorët e tjerë të Bashkisë, si dhe të gjithë aktorët e listuar me cilësi monitoruese në Planin e Veprimit.

Monitorimi i progresit të zbatimit të objektivave dhe masave të këtij plani do të paraqitet në mënyrë periodike dhe do të jetë pjesë e diskutimeve të strukturave drejtuese, Këshillit Bashkiak dhe partnerëve të tjerë vendorë.

Përgjegjës për monitorimin e zbatimit do të jetë Sektori i Shërbimeve Sociale, që mbledh të dhëna dhe identifikon boshllëqet në informacionin që nevojitet. SSHS do të ketë gjithashtu rol koordinues dhe bashkërendues mbi ecurinë e zbatimit dhe do të ketë përgjegjësinë e përgatitjes së progres raporteve vjetore. Në lidhje me monitorimin dhe koordinimin, plani parashikon veprimtari të përmirësimit të sistemit të të dhënave, hartimit të instrumentave të standardizuara të raportimit dhe monitorim-vlerësimit, si dhe përmirësimin e shkëmbimit të informacionit me strukturat e nivelit rajonal, qendror dhe OJF-të.

SSHS është gjithashtu përgjegjëse për kryerjen e një hartëzimi të plotë të shërbimeve në territorin e Bashkisë, duke përfshirë hartëzimin e të gjithë aktorëve, që janë aleatë të mundshëm. SSHS e përditëson periodikisht hartën duke futur gradualisht të gjitha shërbimet e reja të krijuara sipas angazhimeve në Planin

Vendor të Përfshirjes Sociale dhe legjislacionin në fuqi. Instrumenti i hartëzimit të shërbimeve i shërben vlerësimin të mbulimit me këto shërbime të territorit të bashkisë, mundëson programimin e mbështetjes së këtyre shërbimeve me burime njerëzore dhe financiare dhe gjithashtu vlerëson qëndrueshmërinë e ofrimit të tyre duke informuar në kohë vendim-marrjen për masat përkatëse sipas rastit.

Si realizohet monitorimi?

Monitorimi është procesi i vazhdueshëm i mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit drejt arritjes së objektivave strategjike dhe specifike të këtij Plani Social. Ai siguron mbledhjen sistematike të të dhënave në lidhje me zbatimin e këtij plani për të siguruar përmirësim të vazhdueshëm. Monitorimi dhe vlerësimi është një pjesë kritike e menaxhimit të mirë të programit dhe llogaridhënies. Përmes monitorimit, zbatuesit dhe aktorët përgjegjës për këtë plan sigurohen që aktivitetet që kryhen janë në përputhje me ato të planifikuara dhe brenda afateve kohore të përcaktuara. Gjithashtu, monitorimi parashikon edhe marrjen e masave korrigjuese ku ka devijime si edhe bën të mundur parashikimin e vështirësive para se të shfaqen. Monitorimi kryhet në intervale kohore mujore, tremujore, gjashtëmujore, vjetore dhe kërkon informacion nga tre fusha kryesore:

- Inputet, burimet që përdoren për realizimin e planit, që përfshijnë stafin, financat, materialet dhe kohën;
- Proceset, numri i aktiviteteve ku përdoren burime njerëzore dhe financiare për të arritur rezultatet e pritshme të planit;
- Outpute/produkte/shërbime, rezultatet e menjëhershme që përftohen përmes realizimit të aktiviteteve.

Afatet kohore të monitorimit do të vendosen nga njësia përgjegjëse në varësi të kohëzgjatjes së çdo aktiviteti. Aktivitetet afatshkurtra do të monitorohen në intervalet më të ngushta kohore, ato tremujore.

Vlerësimi

Në dallim nga monitorimi, ku të dhënat mbledhen periodikisht dhe përdoren për të matur progresin, vlerësimi është një analizë e detajuar e planit që synon të rishikojë arritjet e planit përkundërt pritjeve të planifikuara, dhe të përdorë përvojën e fituar për të përmirësuar hartimin e planeve në të ardhmen. Vlerësimi

fokusohet në rezultate duke marrë në konsideratë inputet (burimet); rezultatet në lidhje me koston; procesin e përdorur për të arritur rezultatet; relevancën e përgjithshme; ndikimin; dhe qëndrueshmërinë. Vlerësimi identifikon efektet dhe ndikimet e performancës së planit duke u fokusuar në analizën e progresit drejt arritjes së objektivave.

Raportimi

Raportimi mbi zbatimin do të realizohet në bazë të raporteve të përvitshme nga njësia përgjegjëse.

VIII. Burimet financiare

Ky kapitull trajton në mënyrë të përmbledhur burimet financiare, të nevojshme për zbatimin e “Planit të Përfshirjes Sociale 2019-2022” për Bashkinë Roskovec.

Kostimi i planit të veprimit u realizua mbështetur në informacionet e ofruara nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Buxhetit në Bashki. Për kostimin e planit të veprimit u përdor një metodologji e kombinuar, pasi plani përfshin disa sektorë. Metodologjia kryesore e përdorur është kostimi i bazuar në aktivitete. Kostimi u realizua duke u mbështetur në koston e secilit aktivitet të pasqyruar në planin e veprimit. Në llogaritjen e shpenzimeve totale u mbajt në konsideratë kohështrirja e masës, numri i aktiviteteve që do të realizohen, numri i përfituesve për aktivitete të caktuara, etj. Për disa aktivitete, që ishin të përfshira në buxhetin afatmesëm u vendosën shpenzimet sipas PBA-së. Në disa raste u përdor dhe vlerësimi për analogji, i cili merr në konsideratë shpenzimet e bëra për aktivitete të ngjashme. Kostimi i Planit të Veprimit u realizua gjithashtu bazuar në praktikën e planifikimit buxhetor dhe metodologjinë e hartimit të buxhetit afatmesëm.

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e masave, nga të gjitha burimet e financimit, është rreth 190 milionë lekë ose afërsisht 1.5 milionë euro⁵. Parashikimi i fondeve për periudhën 2019-2022 u programua duke mbajtur në konsideratë tavanet e projektbuxhetit afatmesëm (PBA 2020-2022). Burimet financiare nga buxheti i shtetit mbulojnë rreth 33.7% të koston së planit të veprimit, përkatësisht rreth 63.9 milionë lekë. Ndërsa burimet e financimit të angazhuara nga bashkia mbulojnë 10.9% të koston së planit të veprimit ose 20.7 milionë lekë.

Tabela 11 paraqet buxhetin në vite sipas objektivave strategjike. 80.8% e shpenzimeve nevojiten për objektivin strategjik 2 “Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit”.

5 Kursi këmbimit 1Euro=125 lekë

Tabela 11. Buxheti sipas objektivave strategjik për periudhën 2019-2022

PËRSHKRIMI	Buxheti 2019-2022				
	VITI 2019	VITI 2020	VITI 2021	VITI 2022	TOTALI
Objektiv strategjik 1. Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi, koordinimi dhe vlerësimi i shërbimeve shoqërore në Bashkinë Roskovec	1,162,000.00	1,888,128.00	3,369,328.00	3,981,328.00	10,400,784.00
Objektiv strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit	37,095,760.00	53,243,160.00	31,670,320.00	31,670,320.00	153,679,560.00
Objektiv strategjik 3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuar	1,704,000.00	2,204,000.00	2,204,000.00	2,204,000.00	8,316,000.00
Objektiv strategjik 4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre	1,101,880.00	1,791,000.00	2,465,000.00	6,242,600.00	11,600,480.00
Objektiv strategjik 5: Mbrojtja e të moshuarve dhe të drejtat e tyre	360,000.00	2,200,000.00	1,200,000.00	1,200,000.00	4,960,000.00
Objektiv strategjik 6 – Përmirësimi i politikëbërjes, vendim marrjes dhe planifikimit në fushën e shërbimeve shoqërore përmes mbështetjes në evidencën dhe pjesëmarrjes së grupeve të synuara	0.00	348,000.00	348,000.00	348,000.00	1,044,000.00
Total (1+ 2 +3 +4 +5 +6)	41,423,640.00	61,674,288.00	41,256,648.00	45,646,248.00	190,000,824.00
Në %	21.8%	32.5%	21.7%	24.0%	100.0%

Tabela 12 paraqet shpenzimet sipas burimeve të financimit dhe hendekun financiar për secilin nga objektivat specifike. Hendeku financiar i pambuluar nga buxheti është 54.3%. Pjesa më e madhe e hendekut financiar është për objektivin 2, ku përfshihen projektet e strehimit social. Rreth 69.9% është shuma që nevojitet për projektet e strehimit social. Bashkia ka përfituar nga fondet e buxhetit të shtetit për strehimin dhe do të vazhdojë të aplikojë dhe në të ardhmen. Pjesa tjetër e hendekut financiar mendohet të mbulohet nga donatorë të ndryshëm dhe organizata të shoqërisë civile. Hendek financiar ka kryesisht për aktivitete plotësuese si: fushata ndërgjegjësuere vendore, prodhimin e materialeve informuese, programe për rritje kapacitetesh dhe trajnime.

Tabela 12. Shpenzimet sipas burimeve të financimit

PËRSHKRIMI OBJEKTIVAT, AK- TIVITETET	FINANCIUAR NGA						Nevojat për
	Bashkia	Qeveria	Donatorët	Të tjerët	TOTALI	Fonde LEKË	
Objektivi strategjik 1. Fuqizimi, mirë-strukturimi, organizimi....	9,830,784.00	102,000.00	0.00	0.00	9,830,784.00	570,000.00	
Objektivi strategjik 2 - Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë, nxitja e punësimit	7,365,240.00	56,130,320.00	0.00	480,000.00	63,975,560.00	89,704,000.00	
Objektivi strategjik 3. Përmirësimi i cilësisë së jetesës së personave me aftësi të kufizuara	1,716,000.00	2,200,000.00	400,000.00	0.00	4,316,000.00	4,000,000.00	
Objektivi strategjik 4. Mbrojtja e fëmijëve dhe e të drejtave të tyre	1,848,080.00	5,564,800.00	0.00	200,000.00	7,612,880.00	3,987,600.00	
Objektiv strategjik 5: Mbrojtja e të moshuareve dhe të drejtave të tyre	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	4,960,000.00	
Objektiv strategjik 6 – Përmirësimi i politikëbërjes.....	0.00	0.00	0.00	1,044,000.00	1,044,000.00	0.00	
Total (1 + 2 + 3 + 4 + 5 + 6)	20,760,104.00	63,997,120.00	400,000.00	1,724,000.00	86,779,224.00	103,221,600.00	
Në %	10.9%	33.7%	0.2%	0.9%		54.3%	

IX. Shtojca

IX.1 Metoda dhe teknika për mbledhjen e të dhënave parësore, me pjesëmarrjen e komunitetit

Diskutimet në Fokus-Grup

Organizimi i fokusgrupeve rekomandohet nëse vlerësoni se ka nevojë për informacione shtesë nga anëtarët e komunitetit (kryesisht grupe homogjene, por të nënpërfaqësuar si p.sh gratë, të rinjtë etj.). Një fokusgrup rekomandohet të mbahet me një grup nga minimumi 8 deri në 15 pjesëmarrës. Lehtësuesi prezanton kontaktin në të cilin organizohet fokusgrupi, qëllimin e tij dhe mënyrën si do të përdoren të dhënat e gjeneruara përmes fokusgrupit. Më pas ai lehtëson diskutimin në grup duke treguar kujdes që të mos e drejtojë bisedën dhe të përfshijë sa më shumë pjesëmarrësit në diskutime. Hapat konkrete përfshijnë:

- Ftesa për pjesëmarrje të përfaqësuesve të nën-grupeve të nënpërfaqësuar në metodat e tjera të mbledhjes së të dhënave.
- Prezantimi i grupit me pyetje të gjashme me ato të matricës;
- Regjistrimi i të gjitha përgjigjeve në mënyrë anonime dhe dërgimi i tyre pranë ekspertëve përkatës.

Analiza e rrjedhës së shkaqeve

Edhe kjo metodë mund të përdoret në grup të madh ose të zhvillohet një herë në grupe më të vegjël e më pas të dakordësohet në grup të madh. Lehtësuesi u kërkon pjesëmarrësve të diskutojnë dhe më pas vizatojnë diagrama të shkaqeve që çojnë në situata/probleme të caktuara. Ky ushtrim i shërben shumë mirë eksplorimit të perceptimeve të komunitetit mbi shkaqet e problemeve dhe arsytet përse ato vijojnë.

Pema e problemit është një teknikë që mund ta lehtësojë këtë proces. Në të paraqiten në mënyrë vizuale dhe të përmbledhur shkaqet e problemit – tek rrënjët e pemës; problemi që po analizohet – në trung; pasojat ose efektet e tij – tek gjethet dhe frytet e pemës.




Figura 6. Pema e problemit.

Matrica e problematikave dhe adresimi i tyre

Ndërtimi i matricës së aktorëve është një ushtrim, që mund të përdoret si me anëtarët e komunitetit ashtu edhe në takimet me përfaqësues të institucioneve. Ajo synon evidentimin e çështjeve kryesore për çdo fushë interesi, të prekurit prej problematikës/çështjes, nevojat specifike që ka komuniteti i synuar në lidhje me të, pengesat që hasen, aktorët përgjegjës dhe mundësisë për adresimin e problematikës/nevojës.

Ushtrimi mund të lehtësohet nga lehtësuesi vendor me gjithë grupin e madh ose mund të realizohet në grupe të vogla para se të dakordësohet në grupin e madh. Në variantin e dytë, lehtësuesi kërkon që grupi të ndahet në disa grupe të vogla (mund të sugjerohet të ndahen sipas interesave ose asaj që përfaqësojnë në takim) dhe secili grup cakton një lehtësues dhe prezantues për punën. Në fund të procesit secili grup përmbledh diskutimet e tij në një tabak letre me një tabelë si ajo që ilustron më poshtë.

Lehtësuesi kryesor, pasi dëgjon prezantimet e tabelave nga secili grup i vogël, i kërkon grupit të madh të diskutojnë mbi to dhe dakordësojnë një tabelë përmbledhëse të aprovuar si përfundimtare nga i gjithë grupi. Ky proces ndihmon që të ndërtohet një konsensus lidhur me të gjithë elementët që përmban tabela.

Tabela 13. Model për matricën e problemeve kryesore dhe zgjidhjen e tyre.

Fusha	Cilat janë çështjet kryesore?	Kush preket?	Cilat janë nevojat/kërkesat e komunitetit rom?	Çfarë pengesa hasin?	Kush është përgjegjës?	Çfarë propozime kemi?
Arsimi						
Shëndeti						
Etj.						

IX.2 Lista e dokumenteve të konsultuara

Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2016-2020, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2016 <https://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/PAK%20shqip.pdf>

Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2015 http://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/06/Strategjia_Kombetare_per_Mbrojtjen_Sociale_2015-2020.pdf.

Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2015–2020, Këshilli i Ministrave: Ministri për Cështjet Vendore, 2015 <https://www.bpe.al/sites/default/files/publications/Strategjia-ndersektoriale-per-decentralizimin-dhe-qeverisjen-vendore.pdf>

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016-2020. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2016 <https://www.un.org.al/sites/default/files/SKGJB-AL-web.pdf>

Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë 2015-2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2015, <https://arsimi.gov.al/plani-kombetar-i-veprimit-per-rinine-2015-2020/>

Strategjia e Zhvillimit të Arsimit Parauniversitar 2014-2020, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, 2014 <http://arsimi.gov.al/strategjia-e-zhvillimit-te-arsimit-parauniversitar-2014-2020/>

Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, 2017 https://childhub.org/en/system/tdf/library/attachments/agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve_0.pdf?file=1%26type=node%26id=27392

Ligj nr. 115/2014 datë 31.7.2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Ligji nr. 163/2014, “Për Urdhrin e Punonjësve Socialë në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”

Ligji nr. 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologëve në Republikën e Shqipërisë”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 111, datë 23.2.2018 “Për krijimin dhe funksionimin e Fondit Social”

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar.

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 3.10.2018 “Për procedurat e referimit e të menaxhimit të rastit, hartimin dhe përmbajtjen e planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes

Udhëzim i Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 689, datë 2.10.2018 Për nivelin e kuotave të shpenzimeve për ushqime, në institucionet publike rezidenciale e komunitare të përkujdesjes shoqërore.

Udhëzues: Instrumentet për planifikimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, ESA & UNICEF, 2016.

IX.3 Grupi Institucional i Punës, Bashkia Roskovec

Emër Mbiemër	Pozicioni
Everina Tafa	Drejtoreshë e Sektorit të Projekteve sociale, Koordinimit me BE-në
Selman Çepele	Drejtor i Financës dhe i Ekonomisë
Arben Dukaj	Përgjegjës i Sektorit të Zbatueshmërisë së Investimeve
Eralda Duraj	Përgjegjëse e Sektorit të Arsimit
Elis Apostoli	Përgjegjës i Shërbimeve Sociale
Rakip Hazizaj	Drejtor i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit
Asqeri Ruko	Drejtor i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural
Makelian Haxhiaj	Punonjës i Shërbimeve Komunitare

IX.4 Vendimi i Këshillit Bashkiak Roskovec



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 290 Prot.

Roskovec.me 21.05 2019

VENDIM

NR. 47 DATË 17.05 2019

PËR

MIRATIMIN E PLANIT SOCIAL TË BASHKISË ROSKOVEC 2019- 2022

Në mbështetje të Ligjit Nr.139/2015 "Per Vetqeverisjen Vendore", Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë", ligji nr.9355 date 10.03.2005 ndryshuar me ligjin Nr.9602 date 28.07.2006,ligjin Nr.10252 date 11.03.2010,ligjin Nr.25/2013,Ligjin Nr.47/2014,ligjin Nr.44/2016 "Per Ndihmen dhe Shërbimet Shoqërore",ligji nr.18/2017 "Per te drejtat dhe mbrojtjen e femijes" Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

-Miratimin e Planit Social te Bashkise Roskovec 2019-2022.

Plani i Shërbimeve Sociale i Bashkise Roskovec 2019-2022 eshte nje dokument politikash specifike per grupet dhe komunitetet e targetuara ne territorin e Bashkise,ne perputhje te plote me Strategjine e Mbrojtjes Sociale dhe Strategjine Kombetare per Zhvillim dhe Integrim.

Bashkengjitur Plani Social i Bashkise Roskovec 2019 – 2022.



ROMANACTED

*Promovimi i qeverisjes së
mirë dhe fuqizimit Rom
në nivelin vendor*

SQI

Këshilli i Evropës është organizata udhëheqëse e kontinentit për të drejtat e njeriut. Përbëhet nga 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një traktat i projektuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikqyr zbatimin e Konventës në shtetet anëtare.

www.coe.int

Vendet anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të bashkojnë njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Bashkarisht, kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qendrueshëm krahas ruajtjes së diversitetit kulturor, tolerancës dhe lirive individuale. Bashkimi Evropian angazhohet në ndarjen e arritjeve dhe vlerave me vendet dhe njerëzit përtej kufinjve të vet.

www.europa.eu

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës